

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
SOUTH-EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË  
FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMY

## TEZË MASTERI

**Efekti nga vlerësimi i mallit të importuar për qëllime doganore në kostot shtesë të kompanive gjegjësisht të hyrat shtesë fiskale në buxhetin e Republikës së Kosovës**

**Mentori:**

Prof.Dr. Rufi Osmani

**Kandidati:**

Faton Krivanjeva

Tetovë, 2019

## Përmbajtja

I. Lënda e hulumtimit.....	1
II. Qëllimi i hulumtimit .....	1
III. Hipotezat.....	2
➤ Hipoteza kryesore: .....	2
➤ Hipotezat ndihmëse:.....	2
IV. Metodologjia e hulumtimit.....	2
V. Rëndësia e punimit .....	2
1.1 Qëllimi i vlerësimit të mallit, stabiliteti i çmimeve .....	4
1.2 Luftimi i nënvlerësimit të mallit .....	29
1.3 Luftimi i evazionit fiskal, konkurrencës jo të drejtë .....	30
2. Baza ligjore e vlerësimit të mallit për qëllime doganore .....	31
2.1 Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës (KDAK ) nr. 03/L-109.....	31
2.2 Udhëzimi Administrativ 11/2009 për implementimin e KDAK-së .....	31
2.3 Udhëzimi Administrativ nr.67/2009 mbi përdorimin e të dhënave të disponueshme .....	32
2.4 Neni 7 i GATT-it dhe Marrëveshja për Implementim.....	32
2.5 Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë-OBT - Vlera e transaksionit.....	33
3. Vlera doganore e mallit.....	35
3.1 Neni 32 deri 40 i KDAK-së .....	35
4. Metodatat e vlerësimit të mallit .....	37
4.1 Metoda-vlera faktuale apo vlera e transaksionit .....	37
4.1.1 Shpenzimet që duhet shtuar vlerës transaksionale.....	39
4.1.2 Shpenzimet që nuk shtohen në vlerën transaksionale të mallit.....	41
4.2 Metoda-vlera e transaksionit të mallit identik .....	41
4.3 Metoda-vlera e transaksionit të mallit të ngjajshëm.....	41
4.4 Metoda-çmimi për njësi.....	42
4.5 Metoda-vlerës së përlogaritur .....	43
4.6 Metoda-të dhënat e disponueshme .....	43
5. Sfidat e vlerësimit të mallit .....	44

5.1 Deklarata e vlerës-formulari D.V.1 .....	45
6. Reflektimi i vlerësimit të operatorët ekonomik-raste studimore nga njësitë kërkimore(problematikë e shtruar nga anketuesit).....	46
7. Rezultatet nga mbledhja e të dhënave primare .....	54
8. Efekti i vlerësimit të mallit në të hyrat doganore .....	56
9. Kontrolli pas Importues i operatorëve ekonomik.....	58
10. Përfundim .....	60
11. Rekomandim .....	60
12. Bibliografia .....	62
<a href="https://dogana.rks-gov.net/">https://dogana.rks-gov.net/</a> .....	62

## **Lista e shkurtesave**

<b>RKS</b>	Republika e Kosovës
<b>DK</b>	Dogana e Kosovës
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>MTI</b>	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
<b>BQK</b>	Banka Qendrore e Kosovës
<b>BK</b>	Buxheti i Kosovës
<b>ATK</b>	Administrata Tatimore e Kosovës
<b>SHBA</b>	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>UE</b>	Unioni Evropian
<b>KDAK</b>	Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës
<b>UA</b>	Udhëzimi Administrativ
<b>OBT</b>	Organizata Botërore e Tregtisë
<b>WTO</b>	World Trade Organization
<b>OBD</b>	Organizata Botërore e Doganave
<b>WCO</b>	World Customs Organization
<b>ICC</b>	International Chamber of Commerce
<b>GATT</b>	General Agreement on Tariffs and Trade
<b>TARIK</b>	Tarifa e Integruar e Kosovës
<b>CEFTA</b>	Central European Free Trade Agreement

## **I. Lënda e hulumtimit**

Dogana e Kosovës si agjencion shtetëror ka autoritetin për mbledhjen e të hyrave për Buxhetin e Republikës së Kosovës nga mallrat që importohen, eksportohen apo kalojnë transit nëpër territorin doganor të Republikës së Kosovës. Aktualisht, këto të hyra i mbledhë si detyrime të importit përmes normave të taksës doganore në vlerën e mallit “ad valorem”, akcizës specifike (për njësi) në mallrat e importit, tatimit në vlerën e shtuar TVSH, masave të përkohshme dhe akcizës specifike në produktet vendore me akcizë. Mallrat që eksportohen dhe që kalojnë transit janë të liruara nga pagesa e detyrimeve doganore.

Meqë nga aspekti fiskal ka synim arritjen e objektivave për mbledhjen e detyrimeve doganore nga mallrat e importuara dhe nga produktet vendore me akcizë, sektorët kompetent gjatë punës do të përballen me problemin e përcaktimit të vlerës doganore të mallit të importuar. Nga vlera faturale e mallit, duke shtuar elementet që hyjnë apo duke hequr elementet nuk hyjnë në vlerën faturale të mallit, përmes metodave të vlerësimit të mallit për qëllime doganore, përcaktohet vlera doganore e mallit (në praktikën doganore të Kosovës-baza doganore) mbi të cilën do të aplikohen normat, të cilat varen nga Tarifa e Integruar e Kosovës-TARIK, nën numrin e së cilës është klasifikuar malli. Përmes normës së taksës doganore që ka çdo produkt veq e veq, shteti zbaton politikën e vet doganore. Mbi këtë bazë, do të shtjellojmë metodat e vlerësimit të mallit sipas Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës-KDAK nr.03/L-109 (në tekstin e mëtejme: kodi) dhe efektet e vlerësimit të mallit, shitesës nga vlerësimi te subjektet në procedurë dhe në të hyrat doganore.

## **II. Qëllimi i hulumtimit**

Për përmbushjen e objektivave fiskale, dogana trajton vlerën e mallit mbi të cilën do të aplikon normat për taksën doganore, taksën e akcizës, TVSH, masat tjera mbrojtëse dhe masat e përkohshme. Sipas praktikës doganore në Kosovë dhe vende tjera, vlera transaksionale përfaqëson vlerën faturale. Vlerës faturale, duhet t'i shtohen të gjitha shpenzimet e bëra për mallin e importuar deri në hyrje të territorit doganor të Kosovës, të parapara sipas kodit, për të fituar bazën doganore të mallit mbi të cilën do të llogariten detyrimet doganore duke aplikuar normat e lartcekura që rrjedhin nga TARIK-u.

Ky vlerësim bëhet në mënyrë hierarkike, duke filluar nga metoda e parë deri te metoda e gjashtë, në përputhje me kodin, Udhëzimin Administrativ nr.2009/11 për Implementimin e KDAK-së, Udhëzimin e Brendshëm nr.67 dt.27.04.2009, Nenin 7 të GATT-it dhe Marrëveshjes Gjenerale të Tarifave dhe Tregtisë-GATT dhe praktikave doganore.

Varësisht nga baza doganore më e lartë apo më e ulët do të inkasohen detyrime doganore më të larta apo më të ulëta. Detyrimet doganore janë në përpjesëtim të drejtë me bazën doganore të sistemi në vlerë “ad valorem”. Baza doganore do të jetë shuma (vlera) e tatueshme edhe për TVSH, që do të llogaritet mbi taksën doganore dhe mbi akcizën.

Kur malli vlerësohet sipas metodës transaksionale, vlera doganore pranohet si kosto reale e mallit nga Administrata Tatimore e Kosovës-ATK. Ndërsa nëse malli vlerësohet sipas metodave të tjera, pra nëse vlera faturale e mallit rritet atëherë ATK, shumën e rritur (shtesën) nuk e njeh për kosto reale të mallit (meqë kjo shumë nuk është e paguar) por është vetëm kosto e faturuar.

Vlerësimi i mallit ndryshe nga metoda transaksionale do të rritë diferencën mes kostos reale dhe çmimit shitës të tyre ndërsa kjo reflekton si bazë më e lartë për tatimin në fitim.

Mbi këto premisa, punimi tregon nivelin e aplikimit të këtyre metodave në vlerësimin doganor të mallit, ndikimin e kësaj shtese te operatorët ekonomik dhe në të hyrat doganore për buxhetin e vendit.

### **III. Hipotezat**

Për qëllime të lidhjes funksionale të lëndës për qëllime hulumtimi në kuadër të këtij studimi , do të parashtrojmë:

➤ **Hipoteza kryesore:**

- **Aplikimi i vlerës transaksionale të mallit të importuar synon të konstatojë koston reale të mallit në funksion të doganimit objektiv për realizimin e objektivave fiskale të shtetit të Kosovës**

➤ **Hipotezat ndihmëse:**

- **Aplikimi i metodave tjera të vlerësimit dhe efektet e shtesës së vlerësimit në koston e mallrave të operatorëve ekonomik**
- **Domosdoshmëria e vlerësimit të disa mallrave sipas metodës së gjashtë të vlerësimit efekturon rritjen e koston së mallrave të importuara**

### **IV. Metodologjia e hulumtimit**

Gjatë hulumtimit janë përdorur të dhëna primare dhe sekondare. Pra do të merren për studim të dhënat nga puna praktike të cilën e zhvillojmë në Doganën e Kosovës, nga institucione të tjera si Organizata Botërore e Doganave, Oda Ndërkombëtare e Tregtisë, Banka Qendrore e Kosovës të dhënat nga operatorë ekonomik. Do të përdoren metoda analitike dhe statistikore, për trajtimin e temës sonë. Përmes tabelave dhe grafiqeve janë krahasuar të dhëna të ndryshme në kuadër të hulumtimit tonë. Rezultatet nga krahasimet do të pasqyrojnë aplikimin dhe efektet e metodave në fjalë.

### **V. Rëndësia e punimit**

Punimi jep kontribut të vlefshëm në lëminë e vlerësimit të mallit për qëllime doganore dhe efekteve që shkakton vlera e shtuar nga vlerësimi i mallit te operatorët ekonomik (subjektet në procedurë, importuesit) në Republikën e Kosovës.

Vlerësimi i mallit bëhet me rastin e deklarimit të mallit sipas të dhënave të paraqitura në Dokumentin Unik Doganor (dud). Punimi jep shembuj nga respondentët (të anketuarit) mbi praktikat e më parshme të pranimit të shtesës nga vlerësimi si kostos reale e mallit nga administrata tatimore dhe praktika e tanishme e mospranimit të shtesës së vlerësimit si kosto reale e mallit dhe dallimet mes tyre.

Për periudhën e viteve 2010-2018 nën regjimin e importit të rregullt, sipas të dhënave nga sistemet operative Tims dhe Asycuda World (Asycuda), dogana ka arritur që përkundër vështirësive dhe sfidave të ndryshme, krizave dhe trendeve të tregtisë ndërkombëtare, çmimeve të mallit në bursën ndërkombëtare e disa barrierave tregtare, që nën regjimin e importit të rregullt të zhoganojë mall me bazë doganore të përgjithshme prej **23.275.849.583,80 €**.

Duke marrë parasysh mallin e liruar nga procedura të ndryshme doganore, nga kjo vlerë doganore malli, janë inkasuar të hyra të gjithmbarshme prej 8.126.643,292€ për Buxhetin e Kosovës. Nga baza e përgjithshme doganore, 3.09% apo vlera prej 719.058.407,€ është kosto shtesë (kosto e faturuar) nga vlerësimet sipas metodave të ndryshme nga metoda transaksionale, diferencë vlere në bazën doganore nga e cila janë inkasuar 205.780.696 € apo 2.53% të të hyrave të gjithmbarshme.

Në vazhdim, këto të dhëna do t'i paraqesim në forma tabelare dhe përmes grafikeve, për lehtësi krahasimi. Me që, sipas dispozitave në fuqi nuk pranohet shtesa nga vlerësimi si kosto malli, kjo do t'a rrisë diferencën mes kostos reale të mallit dhe çmimit shitës pa TVSH.

Në shtesën nga vlerësimi (koston e faturuar, jo të paguar) subjekti në procedurë do të paguan taksë doganore dhe tatim në fitim ndërsa produktin do t'a bëjë më të shtrenjtë se ai i vlerësuar sipas metodës transaksionale.

### **Abstrakti**

Historikisht, dogana ka qenë burim i madh fiskal i të hyrave shtetërore. Në këtë vështrim, Dogana e Kosovës që nga themelimi i saj, ka pjesëmarrje të lartë të mbledhjes së të hyrave për buxhetin e shtetit. Nga të dhënat e raporteve vjetore të doganës, del se kjo pjesëmarrje në periudhën 2010-2018, është mbi 50%. Nën kushte “ceteris paribus”, shuma e mbledhur e të hyrave për buxhetin e shtetit varet nga mënyra e drejtë, e përcaktimit të vlerës doganore të mallit dhe shpenzimeve të tjera që hyjnë në vlerën doganore të mallit (baza doganore e mallit), mbi të cilën aplikohen normat doganore (%) nga tarifa doganore e Kosovës.

Shuma e detyrimeve doganore është në përpjesëtim të drejtë me lartësinë e bazës doganore të mallit të importuar. Sa më drejtë dhe saktë të përcaktohet baza për tatimim doganor, aq më drejtë dhe saktë do të inkasohen detyrimet doganore për buxhetin e shtetit.

Kjo është me rëndësi te sistemet doganore të cilat mbledhin detyrimet doganore mbi parimin në vlerë “ad valorem”, duke zbatuar normat në përqindje (%) sipas legjislacionit në fuqi.

Si shumica e administratave doganore të vendeve të ndryshme, dogana e Kosovës aplikon mënyrën e llogaritjes së detyrimeve doganore “ad valorem”. Marrë për bazë rëndësinë e vlerësimit të mallit dhe elementeve të tjera që hyjnë në përcaktimin e bazës doganore të mallit, do të trajtohen metodat e përcaktimit të vlerës, legjislacioni në fuqi, efektet e vlerësimit të mallit për qëllime doganore te operatorët ekonomik dhe efektet në të hyrat doganore, rrjedhimisht në buxhetin e Republikës së Kosovës.

## 1. Hyrje

### 1.1 Qëllimi i vlerësimit të mallit, stabiliteti i çmimeve

Dogana e Kosovës, që nga fillimi ka pasur rolin e mbledhjes së detyrimeve doganore si të hyra për buxhetin shtetëror, mbrojtjen e ekonomisë vendore, ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë së vendit prej mallrave, shërbimeve dhe udhëtarëve që kalojnë nëpër territorin doganor të Kosovës. “Sipas rregullit, territori doganor përputhet me territorin shtetëror të një vendi , në të cilin ushtrohet pushteti ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”<sup>1</sup>.

Sipas drejtimit të lëvizjes së mallit (import, eksport, transit), dogana e Kosovës, i mbledhë detyrimet doganore vetëm në mallrat e importit. Regjimet doganore eksport dhe transit janë të lira nga detyrimet doganore.

Ndërsa sipas mënyrës së llogaritjes, i mbledhë obliimet doganore sipas parimit në vlerë “ad valorem”, duke aplikuar norma në përqindje sipas dispozitave ligjore në fuqi. Për disa mallra nga importi, zbaton tatimin e akcizës specifike (për njësi kilogrami, për litër, për copë).

Për mbledhjen e detyrimeve doganore të mallit të importuar, fillimisht duhet përcaktuar vlerën doganore (bazën doganore) të tij, në mënyrë që të aplikohet taksa doganore, akciza, TVSH, eventualisht masat e ndryshme mbrojtëse, masat e përkohshme apo masa të tjera që kërkon legjislacioni vendor. Në raste të caktuara, vlerësimi që bëhet, nuk përputhet me vlerën e deklaruar (paraqitur) të mallit të importuar. Ky vlerësim do të efektuojë importuesin e mallit.

Shtjellimi i kësaj teme, do të shfaqë efektet e vlerësimit të mallit për qëllime doganore në periudhën e viteve 2010 deri 2018. Vlerësimi i mallit për qëllime doganore është proces që zhvillohet kur malli është deklaruar për zhdoganim. Vlerësimi i mallit përfshinë tërësinë e masave dhe veprimeve që ndërmerren për të trajtuar, analizuar, krahasuar dhe gjykuar faktet e paraqitura nga dokumentet që shoqërojnë mallin e importuar me rastin e deklarimit për zhdoganim.

Mbi këto fakte e rrethana nën të cilat është importuar malli, të dhëna krahasuese, të dhëna të tjera të disponueshme, zyrtari i vlerësimit të mallit shprehë gjykimin mbi vlerën doganore të mallit, bazuar në njohuritë e tij dhe informacioneve nga sektorë të tjerë kompetent, në përputhje me dispozitat në fuqi.

Vlera doganore e mallit është vlera e mallit e përcaktuar sipas dispozitave doganore mbi të cilën aplikohen normat e tarifës doganore (Tarik). Meqenëse malli nga importi ngarkohet me detyrime doganore sipas parimit në vlerë “ad valorem atëherë është i domosdoshëm përcaktimi i vlerës doganore të tij. Shuma e detyrimeve doganore do të jetë në përpjesëtim të drejtë me vlerën doganore të mallit. Sa më e lartë të jetë baza doganore e mallit, aq më e lartë do të jetë shumta e detyrimeve doganore për pagesë. Mbledhja e detyrimeve doganore sipas parimit në vlerë “ad valorem” ka dobitë dhe të metat e zbatimit si në vijim.

---

<sup>1</sup> Ylber Rraci, “Bazat e Sistemit Doganor” fq.36 Prishtinë 2010



**Përparësitë:**

- ngarkesë proporcionale e mallit me taksa në varësi nga cilësitë e tij
- përlllogaritje e njëtrajtshme e taksave
- me sukses realizon funksionin mbrojtës nën kushte të stabilitetit të çmimeve në tregun ndërkombëtar

**Dobësitë:**

- në rast të ndryshimeve të theksuara të çmimeve në tregun ndërkombëtar dobësohet roli mbrojtës i doganës
- paraqiten vështirësi me rastin e përcaktimit të vlerës doganore të mallit

Mbledhja e detyrimeve doganore sipas parimit specifik (për njësi) ka:

**Përparësitë:**

- shuma e detyrimeve doganore mbledhet për njësi mase pavarësisht vlerës doganore të mallit.

Taksa doganore specifike në Republikën e Kosovës nuk është e aplikueshme, përveq për produktet e duhanit nga procedura e Përpunimit të Brendshëm, dogana mbledhë tatimin e akcizës në vlerën shitëse të tyre prej 30%.

**Dobësi:**

- malli nga importi ngarkohet jo proporcionalisht me taksë

Ekzistojnë mendime të ndryshme dhe mospajtime lidhur me mënyrën specifike të tatimit (akcizës për njësi) të mallit, sepse sipas kësaj mënyre të ngarkesës së mallit me detyrime doganore, malli me çmim më të ulët do të tatimohet proporcionalisht më shumë se malli me çmim më të lartë. Shembull:

Nëse kemi për zhdoganim mallin për konsum njerëzor:

1. “miell gruri tip 850” në sasi prej 1000kg, me vlerë prej 200€ dhe
2. “miell gruri tip 400” në sasi prej 1000kg, me vlerë prej 300€

atëherë nëse do të aplikohet taksa doganore specifike prej 0.1€/kg dhe duke abstrahuar taksën e TVSH-së, malli do të paguan taksën doganore specifike si në vijim:

1. “miell gruri tip 850”  $1000\text{kg} \times 0.1\text{€/kg} = 100\text{€}$  për pagesë taksë doganore
2. “miell gruri tip 400”  $1000\text{kg} \times 0.1\text{€/kg} = 100\text{€}$  për pagesë taksë doganore

Tani, mospajtimi siç u cek më lartë qëndron në faktin se, malli më i lirë “miell gruri tip 850”, në sasi (të njëjtë me mallin më të shtrenjtë) prej 1000kg dhe në vlerë prej 200€ do të paguan taksë doganore prej 100€, që do të thotë, do të bëhet më i shtrenjtë, do të ngarkohet proporcionalisht për 50% të vlerës së tij ( $100\text{€}/200\text{€} \times 100 = 50\%$ ) ndërsa malli më i shtrenjtë “miell gruri tip 400” poashtu në sasi prej 1000kg (sikur malli i lirë) dhe në vlerë prej 300€ do të bëhet më i shtrenjtë, do të ngarkohet proporcionalisht për 33,33% të vlerës së tij ( $100\text{€}/300\text{€} \times 100 = 33,33\%$ ).

Pra malli më i lirë ngarkohet proporcionalisht më shumë se malli i shtrenjtë. Për të shfrytëzuar përparësitë e mënyrës së llogaritjes së detyrimeve doganore sipas parimit në vlerë “ad valorem” dhe për të evituar të metat sipas parimit specifik, mund të përdoret mënyra e kombinuar e llogaritjes së detyrimeve doganore. Kjo mënyrë konsiston në llogaritjen e taksës doganore në përqindje (%) deri në një vlerë doganore të caktuar të mallit ndërsa pastaj kalohet në tatim sipas parimit specifik (për njësi). Mund të aplikohen modele të ndryshme të kombinuara.

Në Republikën e Kosovës kjo metodë e llogaritjes së detyrimeve doganore nuk është e aplikueshme. Pra, në rast se detyrimet doganore mbledhen sipas taksës doganore specifike atëherë nuk është me rëndësi kritike përcaktimi i vlerës doganore të mallit nga ana e zyrtarëve doganor të vlerësimit sepse malli do të tatimohet për njësi kilogrami, njësi litre, njësi cope, e njësi të tjera matëse.

Në Republikën e Kosovës, dogana mbledhë tatimin e akcizës specifike për njësi kilogrami, njësi litri, njësi cope dhe për vit vjetërsie (merret viti i regjistrimit të parë) të veturave. Në vazhdimësi, gjatë procesit të vlerësimit të mallit, trajtohet përshkrimi i mallit (të dhënat teknike, kualitative, të dhënat rreth përbërjes së mallit, specifika të tjera të mallit), origjina e tij (preferenciale apo jo preferenciale), klasifikimi tarifor i tij, kushtet e dërgesës (pariteti), shpenzimet e transportit dhe shpenzimet tjera të cilat hyjnë apo nuk hyjnë në vlerën doganore të mallit.

Meqenëse mallrat klasifikohen nëpër numra tarifor të ndryshëm, rrjedhimisht i nënshtrohen pagesës sipas normave të ndryshme doganore atëherë është më rëndësi kritike shpërndarja e drejtë e vlerës doganore për mallrat me dërgesa grupore (të përziera). Kjo vlenë edhe me rastin e shpërndarjes proporcionale të shpenzimeve të transportit të dërgesat (e përziera) të dy e më shumë importuesve. Sa për ilustrim, marrim një shembull të një dërgese të përbashkët me tre importues (pronarë malli). Dërgesa me mall është në procesin e vlerësimit të tij.

Vlera e përgjithshme e shpenzimeve të transportit dhe shpenzimeve të tjera për dërgesën është në vlerë prej 4500€. Dërgesa ka mall për zhdoganim për subjektin A (faturat A1, A2), B (faturat B1, B2) dhe C (faturat C1, C2) si më poshtë:

Nr. faturës	Importuesi	Malli	Sasia	Vlera e malliti	Taksa doganore	TVSH
1A	A	Traktor bujqësor	1copë	2000€	0%	0%
2A	A	Gjenerator rryme	1copë	300€	10%	18%
1B	B	Granulat plastik HDPE	1000kg	1250€	0%	18%
2B	B	Kamionetë	1copë	1000€	10%	18%
1C	C	Pllaka porcelani	100m <sup>2</sup>	600€	10%	18%
2C	C	Barëra medicinale	10kg	500€	0%	8%
			Gjithsejtë	5650€		

#### Specifikacion i faturave të dërgesës së përbashkët <sup>2</sup>

Meqenëse kemi mall për tre importues të ndryshëm dhe mall me norma të ndryshme tarifore sipas tabelës si më lartë, është e domosdoshme ndarja proporcionale e shpenzimeve të transportit për tre importuesit sepse është e nevojshme të dihet pjesa e vlerës së shpenzimeve që duhet paguar secili importues. Poashtu është e domosdoshme që të llogariten shpenzimet në mënyrë proporcionale për çdo artikull sipas faturës. Pjesa (vlera) proporcionale e shpenzimeve të llogaritura, i shtohet vlerës

<sup>2</sup> Dogana e Kosovës, nga praktika doganore

faturale të mallit për çdo artikull të faturës dhe i llogariten detyrimet doganore sipas normave si në tabelë, për taksën e doganës dhe për TVSH. Nëse nuk shpërndahen shpenzimet proporcionalisht me vlerën faturale të mallit, atëherë ekziston mundësia që importuesi të gjithë vlerën e shpenzimeve t'i shton vetëm artikullit të parë i cili është i liruar nga detyrimet doganore (shih tabelën më lartë) apo artikujve të tjerë që lirohen nga taksa doganore ndërsa me këtë rast do të mbeteshin pa paguar taksën doganore për vlerën e shpenzimeve, e në tërësi pa u zhdoganuar vlera e shpenzimeve prej 4500€.

Për shpërndarjen proporcionale të shpenzimeve, duhet gjetur koeficientin k nga raporti:

$$k = \frac{\text{Shuma e përgjithshme e shpenzimeve}}{\text{Shuma e përgjithshme e faturave}} = \frac{4500\text{€}}{5650\text{€}} = 0.79646. \quad \text{Pra } k=0.79646.$$

Koeficienti k do të shumëzohet me vlerën faturale të secilit artikull sipas faturës dhe do të fitohet pjesa (shuma) proporcionale e shpenzimeve të transportit që i takojnë çdo artikulli. Duke i mbledhur këto shuma proporcionale për çdo artikull, do të fitohen shumat proporcionale për tre importuesit, respektivisht. Atëherë kemi: k x vlera faturale e artikullit

- 1A     0.79646 x 2000€ = 1592.92€
- 2A     0.79646 x 300€ = 238,94€
- 1B     0.79646 x 1250€ = 995.58€
- 2B     0.79646 x 1000€ = 796.46€
- 1C     0.79646 x 600€ = 477.87€
- 2C     0.79646 x 500€ = 398.23€

Shuma e këtyre vlerave të fituara, na jep vlerën e shpenzimeve prej 4500€, si në fillim të shembullit.

$$\text{Pra, } (1592.92\text{€} + 238.94\text{€} + 995.58\text{€} + 796.46\text{€} + 477.87\text{€}) = 4500\text{€}$$

Importuesve A, B dhe C ju takojnë për pagesë shpenzimet sipas artikujve respektiv. Pasi shpenzimet proporcionale i shtohen vlerës faturale të secilit artikull, fitohet vlera doganore e secilit artikull dhe aplikohen normat tarifore sipas tabelës si më lartë, për të përcaktuar detyrimet doganore për pagesë të secilit artikull.

Dogana, për dërgesat me dy e më shumë importues malli (te dërgesat e përbashkëta) i llogaritet shpenzimet e transportit në mënyrë proporcionale në bazë të vlerës së mallit, deri në hyrje të territorit doganor të Kosovës. Është e njohur edhe mundësia e llogaritjes së tyre në bazë të peshës, mirëpo kjo në Doganën e Kosovës nuk është e aplikueshme.

Trajtimi i kushteve nën të cilat liferohet malli (pariteti i mallit) nga shitësi te blerësi do kujdes të veçantë. Paritetet paraqesin shkurtesa, akronime, të cilat janë të pranuar ndërkombëtarisht. Çdo shkurtesë, ka domethënien e vet dhe përbëhet prej tri shkronjave të mëdha të alfabetit. Pariteti i mallit, saktësisht përcakton se cili nga palët kontraktuese i paguan shpenzimet e transportit, e bartë rrezikun, e paguan sigurimin e mallit, shpenzime të tjera të ngarkim shkarkimit dhe shpenzime të tjera të mallit deri në destinacionin e fundit sipas kontratës së shitësit dhe blerësit të mallit.

Varësisht paritetit, dokumentacionit që shoqëron mallin dhe kushteve të tjera e rregullave mbi vlerësimin e mallit, këto shpenzime hyjnë ose nuk hyjnë në vlerën doganore të mallit. “Pariteti është klauzolë në faturë apo në kontratën e mallit”<sup>3</sup>. Paritetin e mallit duhet analizuar me kujdes të shtuar.

Përgjatë historisë së zhvillimit të tregtisë ndërkombëtare, kanë ndodhur raste të shumta të kontestit se kush i paguan shpenzimet e transportit të mallit, shitësi apo blerësi.

Situatë më e komplikuar është paraqitur kur malli gjatë transportit është dëmtuar apo është shkatërruar plotësisht për arsye të ndryshme (fatkeqësi komunikacioni, fuqi madhore, vjedhje etj). Të shtyrë nga këto arsye, në mënyrë që saktësisht të përcaktohet bartësi i shpenzimeve të transportit të mallit (së bashku me shpenzimet e ngarkim shkarkimit dhe shpenzimeve të tjera të trajtimit të mallit deri në destinacion), të përcaktohet momenti i kalimit të përgjegjësisë te palët kontraktuese dhe të përcaktohet bartësi i riskut e sigurimit gjatë transportit të mallit, Oda Tregtare Ndërkombëtare (International Chamber of Commerce-ICC) bazuar në ligjet tregtare ndërkombëtare, për herë të parë në vitin 1936 ka publikuar rregullat mbi paritetin e mallit INCOTERM (International Commercial Terms).

Krahas zhvillimit ekonomik të shoqërisë në kohë dhe kërkesave të tregtisë ndërkombëtare, në vazhdimësi janë publikuar edhe rregulla dhe inkoterma të rinj deri në publikimin e fundit INCOTERM 2010 (rregulla në fuqi nga data 01.01.2011). Qëllimi ishte “unifikimi i qasjes ndaj dërgesës së mallit, ashtu që të shmangen mosmarrëveshjet dhe kontestet mes shitësit dhe blerësit.

Autenticiteti i pariteteve është i pranuar nga të gjitha gjykatat dhe organet tjera të drejtësisë ndërkombëtare. Kjo ka zvogëluar mosmarrëveshjet dhe ka ndihmuar tregtinë ndërkombëtare”<sup>4</sup>. Në tabelën e mëposhtme, janë dhënë Incoterm 2010. Në përdorim janë 11 prej tyre. Sipas tabelës, vërehet se nga pariteti EXW e më poshtë, shitësit në varësi të paritetit, i rriten përgjegjësitë, rreziku dhe pagesat e tjera të mallit ndërsa me blerësin ndodhë e kundërta.


---

<sup>3</sup> Dogana e Kroacisë <https://carina.gov.hr>

<sup>4</sup> Dogana e Kroacisë <https://carina.gov.hr>



## INCOTERMS 2010



Tabelë nr.1.1 Paritetet e dërgesës sipas INCOTERM 2010<sup>5</sup>

Paritetet kanë kuptimin si më poshtë:

Shkurtesat dhe domethënia	Aplikimi në transport
EXW (ex work)-shitësi ofron mallin në depon e tij, i gatshëm për shitje, pa ngarkim	Të gjitha
FCA (free carrier)-shitësi ofron mallin te transportuesi dhe vendi i caktuar nga blerësi	Ajror, Hek., Rugor
FAS (free alongside)-shitësi ofron mallin përbri anijës në port	Ujor, Detar
FOB (free on board)-shitësi ofron mallin në bordin e anijes, kur malli kalon binarin hekurudhor të saj	Ujor, Detar
CPT (carriage paid to)-shitësi ofron mallin me transport të paguar, vetëm deri te vendii i caktuar nga blerësi	Të gjitha
CFR (cost and freight)-shitësi ofron malli në bordin e anijes, në portin e caktuar nga blerësi	Ujor, Detar
CIF (cost, insurance and freight)-shitësi ofron mallin në bordin e anijes, në portin e caktuar nga blerësi	Ujor, Detar
CIP (carriage and insurance paid to)-shitësi ofron mallin në vendin e caktuar nga blerësi	Të gjitha
DAT (delivery at terminal)-shitësi ofron mallin deri në terminal , paguan terminalin dhe ka rrezikun deri në shkarkim në terminal	Të gjitha
DAP (delivery at place)-shitësi ofron mallin deri në vendshkarkim, blerësi paguan licenca dhe formalitete doganore	Të gjitha
DDP (delivery duty paid)-shitësi ofron mallin në vendshkarkim me licenca dhe të gjitha detyrimet doganore të paguara	Të gjitha

Tabelë nr.1.2 Kuptimet e shkurtesave të pariteteve sipas INCOTERM 2010,ICC

Pariteti i mallit është ndër faktorët që duhet të trajtohet lidhur me përcaktimin e vlerës doganore të mallit.

<sup>5</sup> Dogana e Kosovës <https://dogana.rks-gov.net/>

Shpenzimet e transportit, llogariten varësisht nga pariteti i mallit dhe aplikueshmëria e paritetit të shënuar në dokumentet e mallit. Nga praktika doganore, ka raste kur në faturë të mallit është i shënuar pariteti që nuk është i aplikueshëm në Republikën e Kosovës, ndërsa malli transportohet nga një vend bregdetar, psh. FAS Prishtinë, FOB Gjilan, CFR Ferizaj apo CIF Kaçanik.

Këto paritete janë të aplikueshme në transportin detar apo ujqor të mallit. Në këto raste, dogana e konsideron sikur në dokumente nuk e ka të shënuar paritetin. Pra merret pariteti EXW, me shpenzimet përkatëse të transportit prej nga transportohet malli, i shtohen vlerës së mallit dhe aplikohen normat nga tarifa doganore e Kosovës.

Shpenzimet e transportit, tatimohen me norma të njëjta doganore ashtu siç tatimohet malli me rastin e zhdoganimit. Nëse nuk ka të dhëna mbi shpenzimet e transportit për dërgesën apo nëse shpenzimet e deklaruara të mallit janë të pa pranueshme për doganën (janë dukshëm më të ulëta se transporti i zakonshëm) atëherë duhet referuar transportit të mallit të njëjtë apo mallit të ngjajshëm, sipas nenit 34.2a apo 35.2b të kodit.

Nëse edhe me këtë rast nuk ka të dhëna atëherë duhet referuar Udhëzimit Administrativ për Përcaktimin e Kostos së Shpenzimeve të Transportit të Mallrave të Importuara nr.06/2015 mbi shpenzimet e transportit. Ky udhëzim, përcakton rregullat për llogaritjen e shpenzimeve të transportit ndërkombëtar. Për operatorët ekonomik, që transportin e mallit të vet e realizojnë me mjete vetanake transporti, janë paraparë zbritjet e lejueshme.

“Duke zbatuar rregullat e legjislacionit doganor të vendit të harmonizuara me rregullat e institucioneve ndërkombëtare mbi vlerësimin e mallit për qëllime doganore, vlerësimi duhet të sigurojë një sistem të drejtë, të pa anshëm dhe uniform duke përjashtuar përdorimin e vlerave doganore fiktive, arbitrare dhe të pa bazuara”<sup>6</sup>.

Gjatë zbatimit të këtyre dispozitave, dogana duhet t’aj trajtojë njëjtë mallin për të gjithë importuesit. Në rast se nuk do të vlerësohej malli, do të rrezikohej siguria e qytetarëve të vendit, shëndeti i tyre ndërsa do të vihej në dyshim mbledhja e të hyrave për buxhetin e vendit sipas planifikimeve buxhetore e do të krijoheshin rrethana jo të barabarta konkurrence për ekonominë vendore. Aplikimi i taksave doganore në mallrat e importit ndikon në ngritjen e çmimit të tyre, ndërsa mbrohet pozita konkurrese e mallrave të vendit.

Vlerësimi i mallit sipas dispozitave në fuqi, ruan stabilitetin e çmimeve të produkteve të importit në vend dhe njëherit i “korrigjon” edhe çmimet e produkteve vendore. Pra, produktet vendore i vendosë në pozicion gare me produktet nga importi. Në anën tjetër, dogana e mbronë ekonominë vendore nga konkurrenca jo e drejtë e mallit nga importi, produkteve me çmime të subvencionuara, produkteve me çmime damping.

Vlerësimi i mallit mbronë qytetarët nga importimi i mallrave me prejardhje të dyshimtë, nga mallrat me përdorim të dyfishtë dhe nga mallrat me rrezikshmëri të lartë. Mbronë qytetarët nga mallrat e ndaluara. Mbledhja e të hyrave doganore, varet nga vëllimi i importit në aspektin sasior dhe të vlerës.

---

<sup>6</sup> Dogana e Shqipërisë <http://www.dogana.gov.al/>

Shuma e të hyrave doganore, varet nga çmimet e mallit në tregun ndërkombëtar, nga rregullativa ligjore, struktura e mallit të importuar, marrëveshjet e ndryshme preferenciale, masat e përkohshme, masat mbrojtëse, pakot fiskale, lirimet e ndryshme etj. Varësisht çmimeve të deklaruara të mallit, dogana e vlerëson mallin në përputhje me dispozitat doganore.

Në tabelën e më poshtme, janë dhënë krahasimet e të hyrave doganore të vitit 2010 me vitet paraprake.

	2006	2007	2008	2009	2010
<b>Te hyrat</b>	459.6	526.6	604.8	635.08	700.03
<b>€uro +/-</b>	23.9	67	77.5	30.3	65
<b>% +/-</b>	+5.2%	+12.7%	+13%	+4.7%	+10%

Tabela nr.1.3 Të hyrat doganore prej vitit 2006-2010<sup>7</sup>

Sipas raportit vjetor 2010 të doganës, kjo rritje është ndikuar nga rritja e akcizës së derivateve të naftës, duhanit, të hyrave nga akciza e brendshme për produktet e pijeve alkoholike dhe jo alkoholike, stabilitetit të çmimeve. Nga tabela e mëposhtme, vërejmë rritjen e të hyrave të inkasuara nga importi i rregullt, nga viti 2010 në vitin 2011 për 17.83%, pra nga rreth 691milion € në rreth 814 milion €. Poashtu edhe të hyrat nga shtesat doganore (vlerësimi) kanë shënuar rritje prej 0.89%.

<sup>7</sup> Dogana e Kosovës, Raporti Vjetor 2010


VITI	Metoda	VI. e Deklaruar	Baza Doganore	Shtesa e vlerësimit	% e rritjes	% Pj.në tot.b.dog.	Taksat	% Pj.Taksave	Hyrat nga vlerësimi
2010	VM 1	1,785,089,111.75	1,785,093,357.08	4,245.33	0.00%	86.52%	616,984,377.26	89.31%	1,291.32
2010	VM 2	4,304,039.60	5,638,315.57	1,334,275.97	31.00%	0.27%	1,279,715.58	0.19%	299,041.88
2010	VM 3	11,988,492.05	15,807,453.28	3,818,961.23	31.86%	0.77%	3,272,243.73	0.47%	845,250.11
2010	VM 4	20,934,404.16	39,006,439.97	18,072,035.81	86.33%	1.89%	10,237,610.28	1.48%	4,741,079.27
2010	VM 5	87,286.32	159,484.19	72,197.87	82.71%	0.01%	42,437.45	0.01%	19,067.32
2010	VM 6	140,538,385.65	216,711,480.07	76,173,094.42	54.20%	10.50%	58,389,153.79	8.45%	20,100,507.16
2010	VM NA	742,337.17	742,547.17	210.00	0.03%	0.04%	600,163.10	0.09%	57.96
<b>VITI TOTAL</b>		<b>1,963,684,056.70</b>	<b>2,063,159,077.33</b>	<b>99,475,020.63</b>		<b>100.00%</b>	<b>690,805,701.18</b>	<b>100.00%</b>	<b>26,006,295.01</b>
2011	VM 1	2,055,247,099.79	2,055,249,212.92	2,113.13	0.00%	88.10%	738,929,123.44	90.78%	666.02
2011	VM 2	3,180,128.12	4,016,263.81	836,135.69	26.29%	0.17%	885,116.23	0.11%	194,959.89
2011	VM 3	12,004,777.20	15,094,101.48	3,089,324.28	25.73%	0.65%	2,945,959.59	0.36%	661,811.67
2011	VM 4	13,198,816.47	27,024,746.75	13,825,930.28	104.75%	1.16%	7,236,927.42	0.89%	3,695,468.88
2011	VM 5	28,555.15	63,868.52	35,313.37	123.67%	0.00%	17,300.27	0.00%	9,645.14
2011	VM 6	150,441,854.35	231,125,296.78	80,683,442.43	53.63%	9.91%	63,860,193.70	7.85%	21,675,399.57
2011	VM NA	343,165.73	343,165.73	0.00	0.00%	0.01%	121,018.10	0.01%	0.00
2011	VM NA	163.70	163.70	0.00	0.00%	0.00%	45.18	0.00%	0.00
<b>VITI TOTAL</b>		<b>2,234,444,560.51</b>	<b>2,332,916,819.69</b>	<b>98,472,259.18</b>		<b>100.00%</b>	<b>813,995,683.94</b>	<b>100.00%</b>	<b>26,237,951.47</b>
2012	VM 1	2,171,936,983.13	2,171,936,639.25	-343.88	0.00%	91.80%	763,638,599.82	93.35%	-94.91
2012	VM 2	1,787,863.16	2,158,268.47	370,405.31	20.72%	0.09%	573,182.37	0.07%	93,790.02
2012	VM 3	4,734,370.19	6,141,139.92	1,406,769.73	29.71%	0.26%	1,159,705.55	0.14%	275,637.98
2012	VM 4	4,842,747.16	9,360,489.43	4,517,742.27	93.29%	0.40%	2,492,617.29	0.30%	1,201,490.70
2012	VM 5	46,755.56	80,974.50	34,218.94	73.19%	0.00%	20,950.62	0.00%	7,987.68
2012	VM 6	115,330,826.98	175,187,548.39	59,856,721.41	51.90%	7.40%	49,665,019.26	6.07%	16,773,900.01
2012	VM NA	1,195,958.75	1,195,958.75	0.00	0.00%	0.05%	482,691.89	0.06%	0.00
2012	VM NA	915.00	915.00	0.00	0.00%	0.00%	146.40	0.00%	0.00
<b>VITI TOTAL</b>		<b>2,299,876,419.93</b>	<b>2,366,061,933.70</b>	<b>66,185,513.77</b>		<b>100.00%</b>	<b>818,032,913.21</b>	<b>100.00%</b>	<b>18,352,711.47</b>
2013	VM 1	2,211,465,239.08	2,211,465,239.08	0.00	0.00%	93.22%	769,718,551.64	94.68%	0.00
2013	VM 2	2,809,548.41	3,626,332.02	816,783.61	29.07%	0.15%	760,920.13	0.09%	173,926.92
2013	VM 3	5,113,749.42	7,153,053.26	2,039,303.84	39.88%	0.30%	1,387,561.36	0.17%	419,056.23
2013	VM 4	3,039,302.30	5,602,583.54	2,563,281.23	84.34%	0.24%	1,631,546.38	0.20%	688,510.38
2013	VM 5	102,519.83	135,685.38	33,165.54	32.35%	0.01%	16,477.89	0.00%	6,008.95
2013	VM 6	92,982,748.06	144,334,581.40	51,351,833.34	55.23%	6.08%	39,439,812.99	4.85%	14,053,174.57
<b>VITI TOTAL</b>		<b>2,315,513,107.10</b>	<b>2,372,317,474.67</b>	<b>56,804,367.57</b>		<b>100.00%</b>	<b>812,954,870.39</b>	<b>100.00%</b>	<b>15,340,677.04</b>
2014	VM 1	2,219,141,104.38	2,219,141,104.38	0.00	0.00%	89.58%	754,614,434.26	89.25%	0.00
2014	VM 2	2,696,640.16	3,223,711.47	527,071.32	19.55%	0.13%	1,289,438.56	0.15%	202,228.21
2014	VM 3	6,981,422.57	9,840,658.06	2,859,235.49	40.95%	0.40%	2,561,573.88	0.30%	759,628.44
2014	VM 4	864,635.76	1,574,167.39	709,531.63	82.06%	0.06%	418,611.29	0.05%	190,718.55
2014	VM 5	35,482.77	56,285.12	20,802.34	58.63%	0.00%	15,558.17	0.00%	5,968.08
2014	VM 6	160,357,250.82	243,544,022.42	83,186,771.61	51.88%	9.83%	86,590,841.38	10.24%	26,419,028.12
<b>VITI TOTAL</b>		<b>2,390,076,536.46</b>	<b>2,477,379,948.85</b>	<b>87,303,412.39</b>		<b>100.00%</b>	<b>845,490,457.54</b>	<b>100.00%</b>	<b>27,577,571.41</b>
2015	VM 1	2,232,161,192.13	2,232,161,192.13	0.00	0.00%	86.78%	825,026,224.31	89.11%	0.00
2015	VM 2	1,753,596.49	2,036,407.87	282,811.38	16.13%	0.08%	473,634.07	0.05%	67,370.81
2015	VM 3	2,477,410.25	3,299,961.62	822,551.38	33.20%	0.13%	882,174.01	0.10%	218,600.55
2015	VM 4	156,987.38	258,968.02	101,980.64	64.96%	0.01%	68,657.09	0.01%	28,930.63
2015	VM 5	19,034.98	25,656.15	6,621.17	34.78%	0.00%	7,071.73	0.00%	1,946.58
2015	VM 6	256,379,383.11	334,462,648.74	78,083,265.63	30.46%	13.00%	99,443,002.54	10.74%	21,866,269.83
<b>VITI TOTAL</b>		<b>2,492,947,604.33</b>	<b>2,572,244,834.53</b>	<b>79,297,230.19</b>		<b>100.00%</b>	<b>925,900,763.75</b>	<b>100.00%</b>	<b>22,183,118.39</b>
2016	VM 1	2,506,397,515.55	2,506,397,515.55	0.00	0.00%	90.81%	952,097,859.90	92.83%	0.00
2016	VM 2	3,150,868.92	3,722,655.33	571,786.41	18.15%	0.13%	855,676.43	0.08%	135,313.62
2016	VM 3	1,340,293.34	1,872,185.31	531,891.97	39.68%	0.07%	512,813.74	0.05%	152,013.22
2016	VM 4	136,325.03	189,638.16	53,313.13	39.11%	0.01%	50,198.84	0.00%	15,664.92
2016	VM 5	11,884.17	16,565.96	4,681.79	39.40%	0.00%	4,495.22	0.00%	1,371.02
2016	VM 6	172,562,069.13	247,943,052.07	75,380,982.93	43.68%	8.98%	72,165,666.54	7.04%	21,969,272.93
<b>VITI TOTAL</b>		<b>2,683,598,956.15</b>	<b>2,760,141,612.37</b>	<b>76,542,656.22</b>		<b>100.00%</b>	<b>1,025,686,710.67</b>	<b>100.00%</b>	<b>22,273,635.71</b>
2017	VM 1	2,724,046,097.82	2,724,046,097.82	0	0.00%	90.62%	1,005,316,201.27	92.08%	0
2017	VM 2	2,687,629.66	3,313,541.15	625,911.49	23.29%	0.11%	662,614.96	0.06%	140,051.44
2017	VM 3	40,635,172.35	45,876,706.99	5,241,534.64	12.90%	1.53%	8,351,296.92	0.76%	978,435.66
2017	VM 4	58,138.23	62,065.96	3,927.73	6.76%	0.00%	20,466.20	0.00%	1,170.44
2017	VM 5	49,415.97	72,082.11	22,666.14	45.87%	0.00%	30,104.12	0.00%	10,925.31
2017	VM 6	157,512,242.13	232,574,698.98	75,062,456.85	47.65%	7.74%	77,366,944.10	7.09%	25,813,391.96
<b>VITI TOTALI</b>		<b>2,924,988,696.15</b>	<b>3,005,945,193.01</b>	<b>80,956,496.85</b>		<b>100.00%</b>	<b>1,091,747,627.57</b>	<b>100.00%</b>	<b>26,943,974.82</b>
2018	VM 1	3,028,946,199.81	3,028,946,199.81	0	0.00%	91.08%	1,023,437,934.22	92.87%	0
2018	VM 2	3,786,515.37	4,302,693.92	516,178.55	13.63%	0.13%	772,900.39	0.07%	101,618.27
2018	VM 3	23,805,785.91	25,770,358.02	1,964,572.12	8.25%	0.77%	4,863,821.84	0.44%	434,770.53
2018	VM 4	200,176.79	262,413.95	62,237.16	31.09%	0.01%	68,131.26	0.01%	18,490.39
2018	VM 5	20,969.70	30,196.58	9,226.88	44.00%	0.00%	7,759.45	0.00%	2,261.16
2018	VM 6	194,901,591.33	266,370,827.14	71,469,235.80	36.67%	8.01%	72,878,016.87	6.61%	20,307,620.65
<b>VITI TOTALI</b>		<b>3,251,661,238.92</b>	<b>3,325,682,689.42</b>	<b>74,021,450.51</b>		<b>100.00%</b>	<b>1,102,028,564.03</b>	<b>100.00%</b>	<b>20,864,760.99</b>
<b>TOTALI</b>		<b>22,556,791,176.26</b>	<b>23,275,849,583.57</b>	<b>719,058,407.31</b>			<b>8,126,643,292.29</b>		<b>205,780,696.02</b>

Tabela nr.1.4 Importi i rregullt për vitet 2010-2018<sup>8</sup>

<sup>8</sup> Dogana e Kosovës, Asycuda World, 2019



Grafiku i më poshtëm pasqyron trendin e lëvizjes së të hyrave nga importi i rregullt për vitet 2010 dhe 2011.



Grafiku nr.1.5 Trendi lëvizjes së të hyrave për vitin 2010 dhe 2011

Nga grafiku, mund të shihet se në vazhdimësi të hyrat kanë pasur trendin rritës. Rritja e kërkesës për mallra dhe shërbime, derisa kemi hyrje më të mëdha remitancash, efektuan kërkesën për mallra importi, e rrjedhimisht edhe rritjen e të hyrave doganore.


Kjo vërehet për muajt e verës kur kemi rritje më të theksuar të trendit të të hyrave. Situatë e ngjajshme është edhe në muajin e fundit të vitit. Sipas të dhënave nga BQK, remitancat shënojnë rritje në tremujorin e tretë të vitit dhe në ate të katërt.

Viti	Shuma (në milion Euro)	Pjesëmarrja në total (%)	Viti	Shuma (në milion Euro)	Pjesëmarrja në total (%)
2006	135.1	28.9	2006	184.7	39.5
2007	137.1	26.6	2007	198.7	38.5
2008	126.3	20.8	2008	213.1	35.0
2009 TM1	32.4	26.6	2009 TM1	46.3	38.0
TM2	30.9	21.7	TM2	53.3	37.5
TM3	58.0	33.2	TM3	53.0	30.3
TM4	27.5	18.7	TM4	60.5	41.2
2010 TM1	34.1	28.2	2010 TM1	46.3	38.4
TM2	33.4	23.0	TM2	53.3	36.8
TM3	43.8	26.6	TM3	53.0	32.1
TM4	30.1	19.6	TM4	60.5	39.4
2011 TM1	30.3	24.2	2011 TM1	50.1	40.1
TM2	25.2	18.2	TM2	55.1	39.9
TM3	48.9	29.7	TM3	55.7	33.8
TM4	35.2	22.5	TM4	64.5	41.2
2012 TM1	23.3	19.6	2012 TM1	47.1	39.5
TM2	21.8	15.3	TM2	55.0	38.6
TM3	56.3	32.2	TM3	52.0	29.7
TM4	25.1	14.9	TM4	64.5	38.2

Tabela nr.1.6 Shumat e dërguara të remitancave në Kosovë përmes llogarive bankare dhe agjencioneve për transfer të parave<sup>9</sup>

<sup>9</sup> Banka Qendrore e Kosovës “Analizë mbi mënyrat e dërgimit të remitancave në Kosovë”, prill 2013

Shuma e të hyrave doganore është mbledhur pas vlerësimit të mallit, llogaritjes së shtesës doganore



në vlerën e mallit. Në grafik është pasqyruar vlera e deklaruar e mallit dhe baza doganore pas vlerësimit të tij, taksat e mbledhura nga këto veprime.

Grafiku nr.1.7 Paraqitja grafike e të hyrave të mbledhura nga importi i rregullt për vitin 2010 dhe 2011


Në shumën e mbledhur të të hyrave doganore për këto dy vite, përpos faktorëve të tjerë ka ndikuar edhe marrëveshja preferenciale CEFTA 2006. Sipas kësaj marrëveshje, reduktohet ose hiqet fare norma e taksës doganore për mallin me origjinë nga vendet nënshkruese të kësaj marrëveshje. Sipas tabelës së mëposhtme, malli me bazë doganore si më poshtë, është i reduktuar apo i liruar fare nga taksa doganore prej 10%, me origjinë nga vendet nënshkruese të CEFTA-s 2006.

Origjina e mallit	2010	2011	zvogëlimi / rritja në vlerë
	Baza doganore	Baza doganore	
Magedonia	316,600,791.70	363,290,169.03	14.75%
Gjermania	279,925,456.75	291,219,593.26	4.03%
Serbia	255,678,271.97	251,420,763.72	-1.67%
Turqia	146,267,681.32	178,221,403.42	21.85%
Kina	135,246,224.16	169,769,898.20	25.53%
Italia	100,100,796.09	158,964,866.16	58.80%
Greqia	83,590,057.34	97,814,737.91	17.02%
Shqipëria	60,963,253.32	91,544,906.13	50.16%

Tabela nr.1.8 :Vendet me kryesore importuese të Kosovës për vitin 2010 dhe 2011<sup>10</sup>

Poashtu, struktura e mallit do t'i efetojë të hyrat doganore. Sa për ilustrim, marrim rastin e rritjes rapide të importit të veturave të përdorura, kur nga qeveria e vendit është hequr ndalesa për vetura me mbi tetë vite vjetërsi. Grafiku i më poshtëm tregon për "kërcimin" e lakores së trendit të importit të veturave për copë, për arsyet e shënuara.

<sup>10</sup> Dogana e Kosovës, Raporti Vjetor 2011



Grafiku nr.1.9 Trendi i lëvizjes së importit të rregullt në copë të veturave

Ngritjes së të hyrave doganore për vitin 2011 i ka kontribuar (përpos rritjes së importit të kategorive kryesore të mallrave si duhani, derivatet, veturat etj,) edhe aplikimi i taksës së akcizës për lojërat e fatit. Përkundër faktorëve të ndryshëm, sipas raportit vjetor të vitit 2011, dogana ka realizuar të hyrat e planifikuara për buxhetin e vendit në shkallë prej 99.8% dhe 99.6% për vitet 2010 dhe 2011, respektivisht.


Viti 2012, ka shënuar rritje të mbledhjes së të hyrave. Përpos faktorëve të tjerë, të hyrave i ka kontribuar aplikimi i taksës së akcizës në qeset plastike dhe në gomat e përdorura për automjete. Grafiku në vazhdim pasqyron të hyrat e përgjithshme të doganës që nga themelimi i doganës.



Grafiku nr.1.10 Të hyrat e përgjithshme të doganës për periudhë<sup>11</sup>


Ndërsa, sipas tabelës së mëposhtme, kemi rënie të shtesës nga vlerësimi doganor i importit të rregullt të mallit nga rreth 99.4 milion € për vitin 2011, në rreth 66 milion € për vitin 2012 apo rënie rreth 32.8%, derisa shuma e taksave të mbledhura ka shënuar rritje prej 0.496%. Të hyrat nga vlerësimi mallit nga viti 2011 në vitin 2012 kanë pësuar rënie prej 30.06%. Sipas raportit vjetor 2012 të doganës, kriza në eurozonë, rënia e kërkesës, rënia e investimeve nga jashtë, rënie e çmimeve të derivateve, kanë efektuar rrjedhën e importit.

<sup>11</sup> Dogana e Kosovës, Raporti Vjetor 2012



Grafiku nr.1.11 Paraqitja grafike e vlerës së deklaruar, bazës doganore, shtesës, taksave dhe të hyrave nga shtesa


Faktorët që ndikuan rënien e shtesës nga vlerësimi i mallit janë të natyrave të ndryshme. Nga tabela vërehet se 93.35% e taksave janë mbledhur sipas vlerës transaksionale të importit të rregullt të mallit.



Grafiku nr.1.12 Trendi i lëvizjes së taksave për vitin 2011 dhe 2012


Vërehet trendi rritës i të hyrave në vazhdimësi deri në tremujorin e dytë. Tremujori i tretë përcillet me rënie ndërsa i katërti shënon rritje. Fundi vitit shprehet me rritje të të hyrave.

Viti 2013, shënon vitin e vetëm në të cilin të hyrat nga importi i rregullt, shënojnë rënie në krahasim me vitin paraprak. Nga tabela si më lartë vërehet se edhe pse ka rritje të importit të mallit me bazë doganore prej rreth 6 milion€ apo 0.264% dhe rënie të shtesës nga vlerësimi i mallit për rreth 9.4 milion€ apo 14.16%, të hyrat e përgjithshme kanë pësuar rënie prej rreth 5 milion€ apo 0.62%. Nga kjo rënie janë ndikuar edhe të hyrat nga shtesa doganore prej rreth 3 milion€ apo 16.4%.




Grafiku nr.1.13 Trendi i lëvizjes së taksave për vitet 2012 dhe 2013

Rënia e të hyrave është ndikuar nga struktura e importit sipas peshës neto, sipas disa artikujve që zënë vend në strukturën e importit si duhani dhe veturat e përdorura. Sa për ilustrim , kemi grafikun në vazhdim lidhur me trendin e importit për copë të veturave të përdorura.



Grafiku nr.1.14 Trendi i importit të rregullt të veturave të përdorura për copë për vitin 2012 dhe 2013

Nga të dhënat e sistemit Asycuda, rrjedh se në vitin 2013 sipas importit të rregullt janë importuar 17094 vetura nga 91493 vetura sa ishin për vitin 2012. Nga kjo rënie importi, të hyrat janë efektuar në shumë prej mbi 6.6 milion €, krahasuar me vitin paraprak. Me gjithë ndikimin edhe të faktorëve të tjerë, dogana për vitin 2013 ka performuar sipas grafikut të mëposhtëm.



Grafiku nr.1.15 Paraqitja grafike e vlerës së deklaruar, bazës doganore, shtesës nga vlerësimi, taksave dhe të hyrave nga shtesa

Duke analizuar në vazhdim tabelën nr.4, lehtë vërehet se viti 2014 në krahasim me vitin 2013, shënon rritje të importit të rregullt me bazë doganore prej mbi 105 milion€ apo rreth 4.43% dhe rritje të shtesës doganore prej rreth 30.5milion€ apo 53.7%. Taksat e mbledhura rriten për rreth 32.6milion€apo rreth 4%, ndërsa të hyrat nga shtesat doganore të vlerësimit rriten për rreth 12 milion€ apo 79.76%, për të arritur shumën nominale prej rreth 27.6milion€, më të lartën në periudhën deri në vitin 2018.


Shkaqet e kësaj rritje, përpos kërkesës së shtuar për mallra, strukturës së importit, duhet kërkuar edhe nga “marrja e kontrollit në pikëkalimet në veri të Kosovës, reformës administrative, vlerësimit adekuat të mallrave gjatë importit e sidomos tek mallrat me origjinë nga Azia, pasi këto mallra ngarkohen më së shumti me taksë doganore”<sup>12</sup>.

Në vitin 2015, taksat e mbledhura shënojnë rritje sipas grafikut të mëposhtëm përkundër pakove fiskale për “lirim të lëndës së parë për prodhim, reduktimit të normës së TVSH-së për grupe produktesh në 8% dhe rritjes së normës për grupe të tjera nga 16% në 18%, ndryshimit të akcizës te veturat, duhani dhe lojërat e fatit”<sup>13</sup>.

Trendi i taksave ka pësuar rënie në muajin qershor sipas raportit vjetor 2015, si pasojë e rënies së çmimeve të mallrave në bursën ndërkombëtare.


<sup>12</sup> Dogana e Kosovës, Raporti Vjetor 2014

<sup>13</sup> Dogana e Kosovës, Raporti Vjetor 2015



Grafiku nr.1.16 Trendi i lëvizjes së taksave nga importi i rregullt për vitet 2014 dhe 2015

Lëvizjet e taksave përgjatë vitit 215, kanë vazhduar me trendin rritës, për të përfunduar në fund të vitit me rreth 929 milion€. Shtysë të konsiderueshme mbledhjes së të hyrave i ka dhënë aplikimi i sistemit operativ Asycuda “pa letër-paper less”.



Grafiku nr.1.17 Paraqitja grafike e vlerës, bazës, shtesave, taksave dhe të hyrave nga shtesa

Megjithatë, në vitin 2015, është importuar mall me vlerë prej 102 milion€ apo 4.3% më shumë se në vitin 2014. Baza doganore e mallit ka shënuar rritje prej rreth 95 milion€ apo 3.83% ndërsa shtesa nga vlerësimi rreth 8 milion€ apo 9.17% më pak se viti paraprak. Kjo është reflektuar edhe në të hyrat e mbledhura nga vlerësimi (shtesa) për rreth 5.4 milion€ apo 19.56% më pak.

Dogana në vitin 2016, me rastin e importit të rregullt të mallit ka performuar nën ndikimin nga pakoja fiskale e lirimeve për lëndë të parë për prodhim, linjat e prodhimit dhe pjesët rezervë të tyre, paisje të teknologjisë informative.

	2016		2017		Dif Vlera	% Vlera	Dif Taksa	% Taksa
	Vlera	Lirim Tvsh	Vlera	Lirim Tvsh				
LMP	42,509,813.85	7,587,842.23	44,956,570.70	7,976,713.34	2,446,756.85	5.76%	388,871.11	5.12%
LPP	94,918,302.34	15,420,732.77	103,822,851.36	17,499,718.52	8,904,549.03	9.38%	2,078,985.75	13.48%
LQP	2,354,333.20	465,763.21	1,681,440.42	332,382.05	▼672,892.78	▼28.58%	▼133,381.16	▼28.64%
PTI	1,552,494.60	129,805.73	2,824,362.70	238,871.20	1,271,868.10	81.92%	109,065.47	84.02%
<b>Total</b>	<b>141,334,943.99</b>	<b>23,604,143.94</b>	<b>153,285,225.19</b>	<b>26,047,685.11</b>	<b>11,950,281.20</b>	<b>8.46%</b>	<b>2,443,541.17</b>	<b>10.35%</b>

Tabela nr.1.18 Lirimet sipas pakos fiskale për vitin 2016 dhe 2017<sup>14</sup>

LMP-Linja dhe makineri prodhimi

LPP- Lëndë e pare për prodhim

LQP-Lirim në qarkullim të lire për prodhim

PTI - Paisjet e teknologjisë së informacionit

Sipas të dhënave të tabelës nr.11, lirimet nga detyrimet doganore (taksat) sipas pakos fiskale për vitin 2016 kapin shumën e mbi 23.6 milion € ndërsa për vitin 2017 mbi 26 milion €, me efekt mungese për të hyrat doganore.

	2016		2017		Dif Vlera	% Vlera	Dif Taksa	% Taksa
	Vlera	Taksat	Vlera	Taksat				
Jan	0	0	24,314,732.02	1,717,469.37	24,314,732.02	/0	1,717,469.37	/0
Shk	0	0	30,916,057.47	1,916,348.68	30,916,057.47	/0	1,916,348.68	/0
Mar	0	0	40,928,656.26	2,598,567.69	40,928,656.26	/0	2,598,567.69	/0
Pri	23,836,226.34	1,012,307.08	43,878,353.16	2,670,235.32	20,042,126.82	84.08%	1,657,928.23	163.78%
Maj	33,370,789.51	1,471,452.62	48,952,823.06	2,854,456.14	15,582,033.55	46.69%	1,383,003.52	93.99%
Qer	36,858,830.60	1,685,324.77	45,648,050.89	2,723,077.21	8,789,220.29	23.85%	1,037,752.44	61.58%
Kor	38,603,386.85	1,786,087.41	48,265,530.96	2,736,783.96	9,662,144.11	25.03%	950,696.55	53.23%
Gus	41,091,098.35	1,903,028.58	48,621,563.61	2,813,464.48	7,530,465.26	18.33%	910,435.90	47.84%
Sht	36,069,925.99	1,737,004.33	42,904,830.10	2,555,687.92	6,834,904.11	18.95%	818,683.59	47.13%
Tet	40,361,133.88	2,044,182.88	48,253,755.88	3,059,551.93	7,892,622.00	19.56%	1,015,369.04	49.67%
Nen	39,353,605.35	2,076,880.77	46,559,189.98	2,907,024.58	7,205,584.63	18.31%	830,143.81	39.97%
Dhj	50,055,878.71	2,732,740.36	50,339,544.79	3,280,090.13	283,666.08	0.57%	547,349.77	20.03%
<b>Total</b>	<b>339,600,875.58</b>	<b>16,449,008.81</b>	<b>519,583,088.18</b>	<b>31,832,757.40</b>	<b>179,982,212.60</b>	<b>53.00%</b>	<b>15,383,748.59</b>	<b>93.52%</b>


Tabela nr.1.20 Efekti i aplikimit të MSA në të hyrat doganore nga importi i rregullt për vitet 2016 dhe 2017<sup>15</sup>

Meqenëse nga data 01.04.2016 ka filluar të zbatohet marrëveshja preferenciale MSA me BE-në, të hyrat e vitit 2016 do të ndikohen nga norma e taksës doganore e cila për disa produkte me origjinë nga BE-ja do të reduktohet në 9%, për disa produkte në 8%, e për disa të tjera në 0%. Sidoqoftë koston, BE mbetet partneri kryesor për import për Kosovë dhe eksport të mallit nga Kosova për BE.

<sup>14</sup> Dogana e Kosovës, Raporti vjetor 2016


<sup>15</sup> Sipas 14, po aty





Grafiku nr.1.21 Lakorja e lëvizjes së të hyrave nga importi i rregullt për vitin 2015 dhe 2016


Megjithatë, dogana për herë të parë që nga themelimi i saj tejkalon të hyrat prej 1.025 miliard €.



Grafiku nr.1.22 Krahasim i të hyrave nga importi i rregullt për vitet 2015, 2016 dhe 2017


Përkundër trendit rritës të të dhënave si në tabelën e importit të rregullt, është shënuar rënie në shtesën doganore prej mbi 2.8 milion€ apo 3.59%, ndërsa janë rritur të hyrat nga shtesa për 0.41% në raport me vitin 2015.

Vitin 2017, dogana e përmbyllë me rritje të vlerës së deklaruar për rreth 241 milion€ apo 8.99%, ndërsa bazë doganore prej rreth 246 milion € apo 8.9% se viti paraprak. Shtesat doganore kanë treguar rritje prej rreth 4.4 milion€ apo 5.77% ndërsa shuma e taksave është rritur për 66 milion€ apo 6.44%, nga të cilat janë realizuar rreth 4.7 milion € apo 20.97% të hyra nga shtesa doganore, më shumë se viti 2016. Tabela nr.1.4 jep të dhënat e shënuara.




Grafiku nr.1.23 Trendi i lëvizjes së taksave për importin e rregullt për vitet 2016 dhe 2017

Varësisht strukturës së importit apo faktorëve të tjerë me ndikim, lakorja e taksave mund të ketë rritje apo rënie rapide. Për ilustrim kemi rritjen e sasisë së veturave të përdorura, taksat e të cilave janë me ndikim për të hyrat e doganës.



Grafiku nr.1.24 Importi i rregullt i veturave të përdorura për copë për vitet 2016 dhe 2017

Sipas importit të rregullt, në vitin 2017 janë importuar 34736 vetura, ndërsa në vitin 2016 janë importuar 24323 vetura të përdorura.




Grafiku nr.1.25 Trendi i shumës së taksave të veturave të përdorura për vitet 2016 dhe 2017

Dallimi në sasi i importit të rregullt të veturave të përdorura, reflektohet edhe në taksat e mbledhura. Në vitin 2016 janë mbledhur mbi 57 milion€ ndërsa në vitin 2017 janë mbledhur mbi 80 milion€. Derivatet e naftës, produktet e duhanit dhe veturat janë bartësit të të hyrave, si në tabelën 1.26

Nr	Kreret	
1	2710	Vajrat e naftës dhe vajra të fituara prej mineraleve bituminoze, ndryshe nga vajrat bruto; përgatitje të paspecifikuara dhe të papërfshira
2	2402	Puro, cigare dhe cigarillos, prej duhanit apo prej zëvendësuesve të duhanit:
3	8703	Autovetura dhe mjete të tjera transporti me motor kryesisht të projektuar për transportin e personave (të ndryshme nga ato të kreut Nr. 8

Tabela nr.1.26 Produktet me pjesëmarrje më të madhe në strukturën e të hyrave doganore<sup>16</sup>

Meqenëse malli i përdorur vlerësohet sipas metodave jotransaksionale, i jemi referuar veturave të përdorura. Marrëveshja CEFTA, poashtu ka ndikuar në shumën e të hyrave doganore, sipas grafikut në vazhdim:



Grafiku nr.1.27 Efektet e MSA-së në të hyrat doganore për vitin 2016 dhe 2017


<sup>16</sup> Dogana e Kosovës, Asycuda World, 2019

Grafiku si më lartë, pasqyron lëvizjen e të hyrave të pa arkëtuara për shkak të MSA-së. Sipas të dhënave nga sistemi operativ Asycuda, me aplikimin e marrëveshjes preferenciale, janë liruar mallra nga detyrimet doganore prej 16.449.008,81€ për vitin 2016 ndërsa 31.832.757,40€ për vitin 2017.

	2016		2017		Dif Vlera	% Vlera	Dif Taksa	% Taksa
	Vlera	Lirim Tvsh	Vlera	Lirim Tvsh				
LMP	42,509,813.85	7,587,842.23	44,956,570.70	7,976,713.34	2,446,756.85	5.76%	388,871.11	5.12%
LPP	94,918,302.34	15,420,732.77	103,822,851.36	17,499,718.52	8,904,549.03	9.38%	2,078,985.75	13.48%
LQP	2,354,333.20	465,763.21	1,681,440.42	332,382.05	▼672,892.78	▼28.58%	▼133,381.16	▼28.64%
PTI	1,552,494.60	129,805.73	2,824,362.70	238,871.20	1,271,868.10	81.92%	109,065.47	84.02%
<b>Total</b>	<b>141,334,943.99</b>	<b>23,604,143.94</b>	<b>153,285,225.19</b>	<b>26,047,685.11</b>	<b>11,950,281.20</b>	<b>8.46%</b>	<b>2,443,541.17</b>	<b>10.35%</b>

Tabela nr.1.28 Lirimet e mallit sipas procedurave për vitin 2016 dhe 2017<sup>17</sup>


Grafiku në vazhdim dhe tabela nr.1.28, japin trendin e lëvizjes së lirimeve nga procedurat si në tabelë për vitet 2016 dhe 2017.



Grafiku nr.1.29Trendi i lëvizjes së detyrimeve doganore sipas lirimeve për procedurat LMP, LPP, LQP,PTI.


Nga pakoja fiskale për vitin 2016 janë liruar mallra me detyrime doganore prej mbi 23.6 milion€ ndërsa mbi 26 milion€ për vitin 2017, si në tabelën (nr.1.28) më lartë.

<sup>17</sup> Sipas 16, po aty



Grafiku nr.1.30 Paraqitja grafike e të hyrave nga importi i rregullt për vitin 2016 dhe 2017

Sipas raportit vjetor 2017, dogana nga të gjitha procedurat doganore, ka arritur që të mbledhë 1.121 miliard €, duke tejkaluar projeksionet për 1.2%. Viti 2018, vazhdon me trendin rritës të të hyrave doganore në raport me vitin paraprak. Baza doganore e mallit sipas importit të rrregullt, shënon rritje afër 320 milion€ apo 10.63% ndërsa shtesat nga vlerësimi kanë pësuar rënie rreth 6.93 milion€ apo 8.56%. Shuma e taksave të mbledhura shënon rritje prej mbi 10.28 milion € apo 0.94% ndërsa nga kjo, të hyrat nga shtesa doganore e vlerësimit janë mbledhur rreth 6 milion€ apo 22.56% më pak se në vitin 2017. Tabela nr.4 dhe lakorja në vazhdim, pasqyrojnë lëvizjen e detyrimeve doganore (taksave). Fundi i vitit, zakonisht përcillet me ngritje të të hyrave.




Grafiku nr.1.31 Trendi i lëvizjes së detyrimeve doganore për importin e rregullt për vitin 2017, 2018

Dogana në vazhdimësi e përcjell trendin e importit të produkteve të cilat mbushin në masë më të madhe të hyrat doganore. Duke krahasuar importet e derivateve të naftës, produkteve të duhanit, veturave e artikujve të tjerë, sistemi operativ jep në çdo moment rrjedhën e të hyrave doganore. Viti 2018, karakterizohet më rënie të sasisë së importit të rregullt të veturave të përdorura. Veturat e përdorura, janë subjekt i shtesës doganore, ndërsa për arsye krahasimi, i referohemi importit të tyre sipas tabelës nr.17 dhe grafikut nr.21, si në vazhdim.

	2017						2018					
	Cope	Vlera	Dogana	Akciza	TVSh	Taksat	Cope	Vlera	Dogana	Akciza	TVSh	Taksat
Jan	1,400	7,406,658.39	710,033.72	1,144,300.00	1,626,041.24	3,480,374.96	762	7,217,488.12	688,843.19	354,900.00	1,438,091.78	2,481,834.97
Shk	1,724	9,579,192.52	902,284.85	1,398,300.00	2,063,683.25	4,364,268.10	811	7,562,165.89	731,105.74	401,700.00	1,538,765.12	2,671,570.86
Mar	1,913	9,888,726.26	944,020.02	1,608,700.00	2,180,196.79	4,732,916.81	1,134	9,951,531.17	939,677.16	560,800.00	1,993,259.59	3,493,736.75
Pri	2,054	10,799,639.43	1,034,609.22	1,758,800.00	2,386,165.79	5,179,575.01	1,269	9,376,045.88	887,181.77	599,900.00	1,898,719.40	3,385,801.17
Maj	2,656	11,475,698.34	1,039,749.19	1,903,000.00	2,420,494.24	5,363,243.43	1,358	9,829,428.22	945,003.62	687,000.00	2,020,307.19	3,652,310.81
Qer	2,259	10,510,168.36	995,872.11	1,798,200.00	2,312,486.67	5,106,558.78	1,348	10,928,061.27	1,027,994.33	676,800.00	2,194,122.63	3,898,916.96
Kor	2,731	12,051,767.95	1,156,391.83	2,368,300.00	2,732,390.01	6,257,081.84	1,525	11,735,471.30	1,098,194.63	775,000.00	2,387,240.23	4,260,434.86
Gus	3,328	13,997,778.29	1,314,900.30	2,987,900.00	3,163,927.50	7,466,727.80	1,497	11,342,342.44	1,091,915.78	777,300.00	2,328,864.32	4,198,080.10
Sht	2,853	12,008,762.09	1,161,531.99	2,597,000.00	2,788,496.48	6,547,028.47	1,398	10,207,109.62	983,109.36	710,100.00	2,100,176.65	3,793,386.01
Tet	3,212	14,798,694.95	1,429,775.34	2,927,200.00	3,391,692.66	7,748,668.00	1,742	11,883,329.69	1,127,463.28	881,700.00	2,419,995.97	4,429,159.25
Nen	3,544	15,106,215.94	1,430,378.13	3,295,500.00	3,459,239.22	8,185,117.35	1,655	11,803,376.02	1,099,251.63	847,200.00	2,355,442.33	4,301,893.96
Dhj	7,060	26,264,773.80	2,540,047.68	6,831,400.00	6,286,370.08	15,657,817.76	2,841	17,423,847.06	1,670,681.64	1,638,800.00	3,638,394.86	6,947,876.50
<b>Total</b>	<b>34,734</b>	<b>153,888,076.29</b>	<b>14,659,594.38</b>	<b>30,618,600.00</b>	<b>34,811,183.93</b>	<b>80,089,378.31</b>	<b>17,340</b>	<b>129,260,196.67</b>	<b>12,290,422.13</b>	<b>8,911,200.00</b>	<b>26,313,380.07</b>	<b>47,515,002.20</b>


Tabela nr.1.32: Të dhënat mbi importin e rregullt të veturave të përdorura për vitin 2017 dhe 2018<sup>18</sup>



Grafiku nr.1.33 Trendi për copë i importit të rregullt të veturave të përdorura për vitet 2017,2018

Duke analizuar të dhënat, kuptohet se viti 2018 karakterizohet me rënje prej 50.08% të importit të rregullt të veturave të përdorura apo për 17394 copë më pak, në krahasim me vitin 2017 prej 34734 copësh.

<sup>18</sup> Sipas 19, po aty



Grafiku nr.1.34 Trendi i të hyrave nga importi i rregullt i veturave të përdorura për 2017,2018

Nga grafiku i trendit të lëvizjes në copë, në muajin dhjetor vërehet fluks i madh i importit të veturave të përdorura nga shkaku se importi i tyre është i kufizuar me vitet e vjetërsisë së tyre. Në vitin 2018, rënia e importit të rregullt të veturave të përdorura për copë, rrjedhimisht ka afektuar edhe rënie e shumës së të hyrave doganore, derisa në vitin 2017 dogana ka inkasuar mbi 80 milion €, në vitin 2018 kjo ka rënë në 47.5 milion € apo rënie prej 40.67% të detyrimeve doganore.

Rënie të detyrimeve nga importi i rregullt i mallit, shkaktojnë procedura të ndryshme të lirimit të mallit. Lirimet sipas pakos fiskale, në masë jo të vogël kanë ndikuar të hyrat doganore. Për vitin 2018, nga lirimet e mallit janë shënuar 74 milion€<sup>19</sup> më pak të hyrat doganore.

Rënie e të hyrave doganore, e ndikon edhe origjina e mallit. Malli me origjinë preferenciale, do të afektojë reduktimin apo eliminimin e normës së taksës doganore prej 10%.

Sipas të dhënave nga tabela e më poshtme, duke marrë për krahasim 7 vendet prej nga importon më së shumti Kosova, shihet se vetëm për mallin me origjinë nga Turqia dhe Kina, dogana aplikon normën e plotë të taksës doganore prej 10%. Për mallin me origjinë nga vendet tjera si në tabelë,

	2017		2018		Vlera (+ -)	% (+-)
	Neto Kg	Vlera	Neto Kg	Vlera		
Serbia	1,188,776,557.89	449,305,388.80	1,031,110,810.82	386,475,588.64	▼62,829,800.16	▼13.98%
Germany	153,470,235.13	375,534,555.08	138,509,049.70	391,096,748.20	15,562,193.12	4.14%
Turkey	170,843,274.22	288,226,251.73	196,688,674.87	334,973,876.76	46,747,625.03	16.22%
China	121,202,541.50	273,136,840.81	131,172,077.90	310,970,088.84	37,833,248.03	13.85%
Italy	214,647,202.40	191,931,353.36	173,165,003.09	204,532,112.66	12,600,759.30	6.57%
Albania	919,271,695.88	147,806,502.71	1,044,369,614.45	205,325,617.06	57,519,114.36	38.92%
Fyr Of Macedonia	650,100,550.88	155,547,292.37	692,497,287.48	170,829,431.80	15,282,139.43	9.82%

Tabela nr.1.35 : Vendet nga të cilat Kosova realizon importin më të madhe për 2017,2018<sup>20</sup>

norma e taksës doganore është e reduktuar apo e hequr fare (zero), nëse malli ka dokumentacionin e kërkuar për origjinën preferenciale të vendeve nënshkruese të marrëveshjes preferenciale.

<sup>19</sup> Dogana e Kosovës, Raporti Vjetor 2018

<sup>20</sup> Sipas 19, po aty

Efekti i aplikimit të preferencës së mallit MSA nga 01.04.2016, do të rritet për çdo vit, sepse në vazhdimësi do të reduktohet norma e taksës doganore prej 10%, deri në heqjen në tërësi të saj, në përputhje me marrëveshjen. Ndërsa ndikime do të ketë edhe Marrëveshja Preferenciale me Turqinë (TRMTL) e cila ka filluar të zbatohet nga data 01.09.2019, e faktorë të tjerë të përmendur më lartë. Andaj, të hyrat do të afektohen për çdo vit. Tabela si më poshtë, pasqyron ndikimin e MSA-së për vitin 2017 dhe 2018.

	2017		2018		Dif Vlera	% Vlera	Dif Taksa	% Taksa
	Vlera	Taksat	Vlera	Taksat				
Jan	24,314,732.02	1,717,469.37	32,259,941.72	2,471,035.32	7,945,209.69	32.68%	753,565.95	43.88%
Shk	30,916,057.47	1,916,348.68	38,011,542.08	2,794,588.09	7,095,484.61	22.95%	878,239.42	45.83%
Mar	40,928,656.26	2,598,567.69	47,077,773.78	3,578,629.14	6,149,117.52	15.02%	980,061.45	37.72%
Pri	43,878,353.16	2,670,235.32	52,284,668.50	3,818,801.87	8,406,315.34	19.16%	1,148,566.56	43.01%
Maj	48,952,823.06	2,854,456.14	58,628,535.40	4,322,958.79	9,675,712.34	19.77%	1,468,502.65	51.45%
Qer	45,648,050.89	2,723,077.21	57,479,257.75	4,240,339.04	11,831,206.87	25.92%	1,517,261.83	55.72%
Kor	48,261,608.08	2,736,564.85	55,159,899.79	3,948,019.89	6,898,291.71	14.29%	1,211,455.04	44.27%
Gus	48,472,439.05	2,799,057.19	52,900,081.26	3,691,662.78	4,427,642.22	9.13%	892,605.59	31.89%
Sht	42,805,985.40	2,545,803.45	53,652,801.92	4,119,872.90	10,846,816.52	25.34%	1,574,069.45	61.83%
Tet	47,141,960.02	2,948,372.34	53,330,851.66	3,876,532.82	6,188,891.64	13.13%	928,160.48	31.48%
Nen	46,157,170.50	2,886,844.75	52,928,973.36	3,934,166.15	6,771,802.86	14.67%	1,067,321.40	37.23%
Dhj	50,021,680.34	3,248,189.61	59,989,463.52	4,545,254.98	9,967,783.18	19.93%	1,297,065.37	39.93%
<b>Total</b>	<b>517,499,516.25</b>	<b>31,624,986.58</b>	<b>613,703,790.74</b>	<b>45,341,861.78</b>	<b>96,204,274.49</b>	<b>18.59%</b>	<b>13,716,875.20</b>	<b>43.37%</b>

Tabela nr.1.36 Ndikimi i MSA në importet e rregullta për vitin 2017 dhe 2018<sup>21</sup>

Duke mos lënë anash faktorë të tjerë që ndikojnë në të hyrat doganore, ndryshimi i strukturës së importit, pesha neto e mallit, pesha në litra, produkte që mbajnë barrën më të madhe të të hyrave, dogana vitin 2018 e përmbylli me rritje të bazës doganore të importit të rregullt prej rreth 319 milion€ apo 10.63% më shumë se viti paraprak. Shtesat doganore pësuan rënie rreth 6.93 milion€ apo 8.56% ndërsa detyrimet doganore (taksat) u rritën rreth 10.3 milion€ apo 0.94%.

Të hyrat nga shtesa doganore ranë me rreth 6 milion€ apo 22.56% më pak se viti 2017. Aplikimi i metodës sipas vlerës transaksionale në 91.85% të bazës doganore, reflekton shtesat nga vlerësimi doganor dhe të hyrat nga to.

Pra, malli vlerësohet në mënyrë që dogana të vërtetohet se malli me rastin e impotit i ka përmbushur kërkesat sipas ligjeve të aplikueshme në vend. Ato kërkesa kanë të bëjnë me sigurinë e vendit dhe konsumatorit, me mallrat e ndaluara, mallrat që i nënshtrohen mbikqyrjes doganore dhe përmbushjen e detyrimeve doganore që rrjedhin me rastin e zhdoganimit të mallit.

Nëse nuk do të bëhej procesi i vlerësimit të mallit e rrjedhimisht duke mos zbatuar tarifën doganore, nën kushte hipotetike, malli do të lirohej në qarkullim të lirë, duke iu shmangur kontrollit edhe nga institucionet tjera, sepse me rastin e vlerësimit dhe zhdoganimit të tij, kërkohen certifikata të ndyshme si: certifikata kualiteti, të përdorimit të dyfishtë, sanitare dhe fitosanitare, medicinale, nga agjencione të ndryshme të kontrollit, importi, leje importi etj.

Malli i tillë nga importi, do të dalë në treg me çmime më të ulëta duke çrregulluar stabilitetin e çmimeve nga konkurrenca jo e drejtë. Meqenëse normat doganore dhe akciza nuk janë të ulëta, shmangia nga procesi i përshkruar më lartë do t'i çrregullojë çmimet e produkteve në vend dhe në rajon.

<sup>21</sup> Dogana e Kosovës, Asycuda World 2019



Me përpjekje të mëdha mes vendeve të rajonit është arritur që të përafrohen normat e taksës doganore, të TVSH-së dhe të akcizës në produkte të caktuara, si kundërmasë për parandalimin e kontrabandimit të mallit. Nga arsyet e lartcekura, në Republikën Kosovës nga vlerësimi i mallit në vlerë “ad valorem” për qëllime doganore, varen:

- shuma e taksës doganore
- shuma e taksës së TVSH-së
- vlera e produkteve nga procedura doganore e Përpunimit nën Kontroll Doganor-PKD, të gatshme për zhdoganim
- shuma e taksës së akcizës në çmimin shitës për cigare duhani, nga procedura e Përpunimit të Brendshëm-PB
- shuma e taksave nga masat e përkohshme
- shuma e akcizës për produktet vendore me akcizë
- kualifikimi i veprës kundërvajtëse apo penale, gjatë procedurës së kundërvajtjes doganore dhe lartësia e dënimit
- vlera e garancionit bankar dhe instrumenteve të ngjajshme
- të dhënat statistikore

Përmes vlerës doganore, aplikojmë tarifën doganore dhe masat tjera jo tarifore të politikës tregtare të vendit.

## 1.2 Luftimi i nënvlerësimit të mallit

E drejta e vlerësimit të mallit për qëllime doganore, buron nga Neni 32 deri te Neni 40 i kodit. Nga vlera doganore e përcaktuar, varet shuma e taksës në vlerë “ad valorem”, TVSH-së dhe taksave të tjera eventuale (masat mbrojtëse, masat e përkohshme). “Në lidhje me importimin e mallrave, shuma e tatueshme duhet të jetë vlera për qëllime doganore, e përcaktuar në pajtueshmëri me legjislacionin doganor të Kosovës në fuqi”<sup>22</sup>. Ajo do të jetë vlerë bazë për referim edhe për organe dhe agjencione të tjera administrative, ekzekutive, komunale dhe të zbatimit të ligjit.

Përcaktimi në mënyrë të drejtë dhe të saktë i vlerës doganore të mallit, nuk e pengon tregtinë ndërkombëtare të mallit. Procesi i vlerësimit të mallit për qëllime doganore, e barazon vlerën e mallit me vlerë më të ulët të deklaruar për zhdoganim, me vlerën e mallit të njëjtë apo me vlerën e mallit të ngjajshëm të zhdoganuar sipas metodave të vlerësimit doganor të mallit.

Në rastet kur dogana për arsye të ndryshme, nuk e pranon (vlerëson) mallin sipas vlerës faktuale atëherë ajo vendosë se sipas cilës metodë vlerësimi do t’u cakton vlerën doganore.

Nga praktika doganore, këto deklarime vlerash konsiderohen vlera mallrash të nënvlerësuar. Këto deklarime bëhen me arsyen që malli me bazën doganore më të ulët për tatimim të paguaj më pak detyrime doganore.

Deklarimi i nënvlerësuar i mallit tentohet të bëhet edhe me mosparaqitjen e të gjitha dokumenteve që e shoqërojnë mallin, fshehjen e të dhënave të mallit, deklarinim jo të drejtë të të dhënave teknike, kualitative, shëndetësore, laboratorike, tentim fshehja e origjinës së mallit (përfitimet preferenciale), klasifikimit tarifor, faturat e dyfishta, transaksionet bankare jo të plota e të ngjajshme.

---

<sup>22</sup> Ligji nr.03/L-146 ATK, neni 25

Kur dogana konstaton mbi bazën e këtyre fakteve se është tentuar zhdoganimi i mallit me të dhëna jo të sakta atëherë subjekti në procedurë do t'i nënshtrohet procedurës së kundërvajtjes administrative doganore në përputhje me kodin. Është ndihmesë e madhe bashkëpunimi i doganës me sektorë dhe agjencione të tjera të zbatimit të ligjit në vend dhe bashkëpunimi me administratat doganore të vendeve të tjera. Në raste të caktuara dyshimi, mbi vlerën e deklaruar të mallit, dogana inicon kërkesën për verifikimin e vlerës së mallit në vendin prej nga eksportohet malli. Kjo nuk ka qenë e mundur me vendet të cilat kanë qëndrime politike jo të drejta për Republikën e Kosovës.

### **1.3 Luftimi i evazionit fiskal, konkurrencës jo të drejtë**

Si agjencion i zbatimit të ligjit, dogana ka prioritet të ndërmarrë tërësinë e masave dhe veprimeve, të angazhojë kapacitete analize e kontrolli kundrejt dukurive të evazionit fiskal, tatimor. Fushëveprimi i saj, përqendrohet në parandalimin, zbulimin dhe inkasimin e të hyrave nga evazioni fiskal (shmangiet tatimore dhe evazionet tatimore).

Obligimi për pagesë i detyrimeve tatimore, për importuesin paraqet zvogëlim të potencialit ekonomik (financiar) të tij ndërsa është sjellje subjektive dukuria e refuzimit të pagesës së obligimit tatimor. Ndikohet nga faktorë të ndryshëm në shoqëri si sistemi tatimor, lartësia e normave tatimore profesionalizmi i administratës tatimore, efikasiteti i organeve gjyqësore, shkalla e dënimeve për evazionet tatimore etj.

Evazioni, shmangia apo “mashtrimi rritet”, kur rritet tarifa e tatimit marzhinal, kjo ndodhë sepse një vlerë më e lartë e tarifës marzhinale rritë përfitimin marzhinal nga evazioni. Mashtrimi ulet, kur probabiliteti i zbulimit rritet dhe kur tarifa marzhinale e penalitetit rritet.”<sup>23</sup>. Zakonisht, sistemet tatimore janë të atakura nga këto dukuri. Ndërsa ekzistojnë sisteme tatimore të avancuara dhe efikase të shteteve të zhvilluara, në të cilat mundësitë abuzive janë dukshëm më të ulëta se në sistemet tatimore të vendeve të pa zhvilluara dhe atyre në zhvillim.

Ekzistojnë mendime se duhet bërë dallimin midis shmangies tatimore dhe evazionit tatimor. Sipas Harvey.S.Rosen “shmangia tatimore, është ndryshimi nga ju i sjelljes në mënyrë që të ulni detyrimin tatimor. Nuk ka asgjë ilegale rreth shmangies tatimore”, duke dhënë edhe arsyetimin e bërë nga një gjykatë në SHBA “ Përherë gjykatat kanë thënë se nuk ka asgjë të keqe që dikush t’a rregullojë biznesin në mënyrë që tatimet të jenë sa më të ulëta që të jetë e mundur.

Kushdo vepron kështu, të pasurit dhe të varfërit. Dhe të gjithë veprojnë drejtë, askush nuk ka detyrim që të paguaj më shumë se kërkon ligji...Të kërkosh më shumë në emër të moralit është hipokrizi”(Judge Learned Hand, Commissioner V.Newman, 1974). Evazioni tatimor është mospagimi i detyrimeve tatimore që rrjedhin nga ligji. Nëse mblidhet një tatim mbi këpurdhat dhe ju shisni më pak këpurdha, kjo përbën shmangie tatimore.

Nëse ju nuk i raportoni drejt qeverisë shitjet e këpurdhave, atëherë ky është evazion tatimor”<sup>24</sup>.

Evazioni fiskal (tatimor) nuk është i lehtë për t'u matur, ndërsa bëhen mashtime në forma të ndryshme që nga nënvlerësimi i mallit, kontrabanda me mall, mbajtja e regjistrave tregtar të dyfishtë, raportimi i transaksioneve bankare jo të plota etj.

---

<sup>23</sup>H.Rosen “Public finance” fq.393, sixth edition Tiranë, 2003

<sup>24</sup> H.Rosen “Public finance” fq.391, sixth edition Tiranë, 2003

Sipas raporteve vjetore të publikuara nga dogana, lufta ndër vite kundër evazionit fiskal ka sjellë rezultate të kënaqshme falë “operativës së udhëhequr nga inteligjenca dhe analiza e riskut për të siguruar efikasitet maksimal në luftimin e krimit të organizuar dhe ekonomisë jo-formale”<sup>25</sup>.

Mbetet që krahas me agjencione të tjera të zbatimit të ligjit, të intensifikohet puna kundër kësaj dukurie. Dogana, luftën ndaj evazionit fiskal e ka objektiv strategjik.

“Bazuar në vlerësimet e raportit të projektit të BE-së të vitit 2017, ekonomia joformale llogaritet të jetë rreth 1/3 e GDP-së. Kjo shifër i atribuohet kryesisht evazionit në fushën e tatimeve të brendshme, kontrabandës përmes vijës së gjelbër kufitare si dhe nën deklarimeve të vlerave në import”<sup>26</sup>.

## **2. Baza ligjore e vlerësimit të mallit për qëllime doganore**

### **2.1 Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës (KDAK ) nr. 03/L-109**

Me hyrjen në fuqi të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (KDAK) nr.03/L-109 datë 11.11 2008, është fuqizuar legjislacioni doganor në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, ndërsa mbi bazën ligjore u përcaktua procedura, metodat dhe rregullat e vlerësimit të mallrave për qëllime doganore. Kodi, është në përputhje me Nenin 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme të Tarifave dhe Tregtisë-GATT (General Agreement on Tariffs and Trade) e vitit 1994, e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.01.1995 dhe Marrëveshjes për Implementimin e Nenit 7 të GATT-it të vitit 1994.

Sistemi i Vlerësimit Doganor të GATT-it, bëhet sistem vlerësimi i Organizatës Botërore të Tregtisë-OBT (World Trade Organization-WTO) më 1994 pas formimit të OBT-së dhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Vlerësim Doganor në Marrakesh (Marok).

Kodi doganor dhe Udhëzimi Administrativ 11/2009, përbëjnë rregullativën ligjore në fushën e doganave në Kosovë. Kodi zbatohet pa atakuar rregullat e parapara në fushat tjera për tregtinë ndërkombëtare dhe të Kosovës, mbronë ekonominë e Kosovës, të drejtat dhe obligimet e pjesëmarrësve në procedurën doganore. “Legjislacioni doganor i Republikës së Kosovës do të zbatohet në mënyrë unike në tërë Kosovën”<sup>27</sup>.

### **2.2 Udhëzimi Administrativ 11/2009 për implementimin e KDAK-së**

Udhëzimi Administrativ nr.11/2009 datë 02.09.2009 për Implementimin e Kodit të Doganave dhe Akcizës (UA 11/2009), në lidhje me vlerën doganore, bën interpretime, komente, përkufizime (definicione) dhe jep udhëzime të hollësishme (Kreu 4, Kapitulli 1, nenet 60 deri në 92) për nenet e KDAK-së që kanë të bëjnë me vlerën doganore të mallit, të Kreut 2, Kapitulli 3, nga Neni 32 deri te Neni 40. Jep sqarimet lidhur me aplikimin e metodave të vlerësimit dhe detajizon nenet e lartshënuara. Aneksi 12 i këtij udhëzimi, përmbanë shënimet interpretuese mbi vlerën doganore.

<sup>25</sup> Dogana e Kosovës, Raporti Vjetor, 2018

<sup>26</sup> Objektivat strategjike të DK-së 2019-2023, fq.2

<sup>27</sup> KDAK, neni 3.1

## **2.3 Udhëzimi Administrativ nr.67/2009 mbi përdorimin e të dhënave të disponueshme**

Udhëzimi Administrativ nr.67/2009 datë 27.04.2009, paraqet bazën ligjore për krijimin e të dhënave të disponueshme dhe përditësimin e tyre. Përcakton burimin e informacionit si dhe aspektet tjera të aplikimit të të dhënave të disponueshme.

Ka për qëllim, "unifikimin e procedurës së trajtimit të vlerës së mallit, evitimin e arbitraritetit, pritjet dhe pabarazinë në zbatim të neneve të KDAK-së që kanë të bëjnë me vlerën doganore, si dhe të rrisë efikasitetin në punë"<sup>28</sup>

Udhëzimi, në kuadër të procedurës së përcaktimit të vlerës doganore, renditë një mori indikatorësh dhe të dhënash të disponueshme mbi të cilët zyrtari doganor i vlerësimit të mallit do t'a mbështesë analizën e shqyrtimit të vlerës doganore. Mbi këtë analizë dhe informacione tjera mbështetëse nga sektorë dhe agjencione të tjera, vendosë mbi pranimin apo mospranimin e vlerës transaksionale të mallit, vlerës faturale të deklaruar.

Në rast se nga analiza e këtyre indikatorëve justifikohet plotësisht vlera e deklaruar e mallit, atëherë pranohet vlera e transaksionit apo vlera faturale e mallit. Nëse nga analiza e indikatorëve nuk arsyetohet vlera e transaksionit, apo nëse është e dyshuar, deklaruesi (agjencioni doganor) njoftohet me shkrim në rast se kjo kërkohet.

## **2.4 Neni 7 i GATT-it dhe Marrëveshja për Implementim**

Parim bazë i marrëveshjes GATT, është që malli i importit të vlerësohet sipa vlerës faturale apo sipas metodës së parë të vlerësimit të mallit, sipas metodës transaksionale.

Në rastet kur mallit nuk mund t'i pranohet vlera transaksionale, ai duhet të vlerësohet sipas metodave të tjera të vlerësimit të mallit nga metoda e dytë deri në metodën e pestë. Ndodhë jo rrallë herë, që të mos kemi të dhëna lidhur me mallin që po vlerësohet sipas metodave të shënuara.

Nëse vlera doganore e mallit nuk mund të përcaktohet sipas metodës së parë deri në metodën e pestë, atëherë malli do të vlerësohet sipas metodës së gjashtë të vlerësimit, në përputhje me Nenin 7 të Marrëveshjes GATT 1994 (OBT-Organizata Botërore e Tregtisë) në bazë të të dhënave të disponueshme në vendin e importit të mallit.

---

<sup>28</sup> UA 11/2009, prill 2009

## 2.5 Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë-OBT - Vlera e transaksionit

Me qëllim të promovimit të:

- lirisë së tregtisë ndërkombëtare
- domosdoshmërisë për një sistem standard të procedurave të vlerësimit doganor të mallit
- reduktimit apo eliminimit të barrierave tregtare si tarifatat dhe kuotat
- rëndësisë së Nenit 7 të GATT-it (OBT)
- nevojës për një sistem të drejtë, uniform dhe neutral të vlerësimit doganor
- evitimit të arbitraritetit dhe vlerave doganore fiktive
- dakordimit se bazë për vlerën doganore, në masën më të madhe të mundshme, të jetë vlera transaksionale e mallit
- dakordimit se vlera doganore duhet bazuar në kritere të thjeshta
- procedurës së vlerësimit doganor të mallit se nuk mund të përdoret për luftimin e dampingut,

shtetet nënshkruese u pajtuan për përcaktimin e metodave dhe rregullave për Vlerësimin Doganor, në Marrakesh më 1994. Kjo marrëveshje është baza e një sistemi unik, të njohur ndërkombëtarisht, një tërësie dispozitash që rregullojnë vlerësimin doganor. Shumë shtete, legjislacionin doganor e kanë në harmoni me Marrëveshjen mbi Vlerësimin Doganor të OBT-së.

Kodi Doganor 03/L-109 dhe UA 11/2009 i Republikës së Kosovës, e ka të inkorporuar marrëveshjen në fjalë. “Vlera doganore nënkupton vlerën ashtu siç është përcaktuar në përputhje me Marrëveshjen për Zbatimin e Nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifatat dhe Tregtinë e vitit 1994 Marrëveshja e Organizatës Botërore të Tregtisë-OBT mbi vlerën doganore”<sup>29</sup>. Kjo marrëveshje, parim bazë ka aplikimin, në masën më të madhe të mundshme, të vlerës faturale (transaksionale) të mallit me rasin e vlerësimit doganor.

“Vlera doganore e mallrave të importuara duhet të jetë vlera transaksionale, që është çmimi aktual i paguar apo i pagueshëm, për mallrat që shiten për eksport në vendin e importit”.<sup>30</sup>

Parimet e marrëveshjes së OBT-së:

- Mbështetje në vlerën transaksionale
- Njëtrajtshmëri në vlerë
- Drejtësi dhe neutralitet
- Thjeshtësi dhe standarde të pa anshme
- Përputhshmëri me praktikatat tregtare

Marrëveshja e OBT-së, rregullon:

- Metodologjinë e vlerësimit të mallrave të importuara
- Të drejtat dhe detyrimet e doganës dhe importuesve
- Këmbimin valuator
- Të drejtën në ankesë në vendimet e doganës.

---

<sup>29</sup> UA 11/2009, neni 34.a

<sup>30</sup> World Trade Organization <https://www.wto.org/>

Marrëveshja e OBT-së përcakton metodat e vlerësimit doganor të mallit gjatë importit:

- Vlera e transaksionit të mallrave (MV1)
- Vlera transaksionale e mallrave identike (MV2)
- Vlera transaksionale e mallrave të ngjajshme (MV3)
- Vlera e bazuar në çmimin për njësi (MV4)
- Vlera e përlogaritur (MV5)
- Të dhënat e disponueshme (MV6)

Kodi përcakton se, nëse malli nuk mund të vlerësohet sipas metodës së parë të vlerësimit (MV1), atëherë duhet të vlerësohet sipas metodës së dytë (MV2). Nëse edhe me këtë rast nuk mund të përcaktohet vlera doganore e mallit atëherë do të aplikohen metodat tjera të vlerësimit, sipas renditjes hierarkike. Përjashtim bën rasti kur, vetëm me kërkesën e importuesit, mundet që të aplikohet metoda e pestë (MV5) para metodës së katërt (MV4).

Nëse përsëri nuk mund të përcaktohet vlera doganore e mallit sipas metodës (MV5), atëherë mallit do t'i përcaktohet vlera doganore sipas metodës së gjashtë (MV6) në bazë të të dhënave të disponueshme të doganës dhe në përputhje me Nenin 7 të marrëveshjes së OBT-së së vitit 1994.

Me zbatimin e kësaj marrëveshje:

- "Importuesit marrin më shumë përgjegjësi mbi vlerën e deklaruar të mallit për qëllime doganore
- Zvogëlohet numri i verifikimeve gjatë zhdoganimit të mallit si rezultat i aplikimit të riskut në pranim dhe vlerësim të mallit
- Bëhet përqendrim më i madh i doganës në kontrolla pas zhdoganimit përmes verifikimit të vlerave të deklaruara
- Bëhen ndryshime në legjislacionin doganor
- Zhvillohen procedura në përputhje me praktikën tregtare"<sup>31</sup>.

Të drejtat e doganës dhe importuesit:

- "E drejta e importuesit për shpjegim nga dogana
- E drejta e doganës për të kërkuar deklarimin e vlerës
- Obligimi i dialogut mes doganës dhe importuesit para se të mos pranohet transaksioni i vlerës."<sup>32</sup>

Marrëveshja e OBT-së, rregullon vlerën e mallrave të importuara për vendet të cilat detyrimet doganore i mbledhin sipas parimit në vlerë "ad valorem". Ndërsa nuk rregullon vlerësimin doganor për qëllime të përcaktimit të detyrimeve të eksportit ose administrimit të kuotave në bazë të vlerës së mallrave apo vlerësimit të mallrave për tatimet në brendësi të vendit importues. Lidhur me vlerësimin doganor, Organizata Botërore e Doganave-OB (World Customs Organization-WCO), boton publikimin "Compendium of Custom Valuation" i cili amendamentohet kohë pas kohe. Jep pasqyrë të qartë interpretimesh të Marrëveshjes së OBT-së, ndërsa njofton për:

---

<sup>31</sup> Dogana e Kosovës, Sektori i Vlerës, QKSPEZH, 2011

<sup>32</sup> Sipas 32, po aty

- “Vendimet e Komitetit për Vlerësim Doganor
- Opinione këshilluese
- Komentime dhe interpretime
- Shpjegime
- Raste studimore
- Indekse të ndryshme”<sup>33</sup>. Republika e Kosovës, është anëtare e OBD-së nga data 3 Mars, 2017.

### 3. Vlera doganore e mallit

#### 3.1 Neni 32 deri 40 i KDAK-së

Aplikimi i drejtë i rregullave të vlerësimit doganor të mallit, në përputhje me KDAK-në, ka rëndësi të madhe për operimin efikas të Doganës së Kosovës për mbledhjen korrekte të detyrimeve doganore. Kodi doganor, e trajton vlerën doganore të mallit në përputhje me rregullat e OBT-së, të cilat i ka të inkuorporuara në Kreun 2, Kapitulli 3, që përfshinë nenet 32 deri te neni 40.

Për mallin që kalon në territorin doganor, lind borxhi doganor. Dogana e Kosovës, përcakton vlerën doganore të mallit në mënyrë që të aplikohet tarifa doganore mbi vlerën doganore të mallit që vlerësohet. Me rastin e deklarimit të mallit për zhdoganim, malli duhet të klasifikohet nëpër numra tarifor, numra të cilët kanë norma të ndryshme të taksave doganore.

Këto norma, aplikohen mbi vlerën doganore të mallit, për të mbledhur detyrimet doganore për buxhetin e shtetit. Sipas nenit 33 të kodit, vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë.

Metoda e parë e vlerësimit doganor të mallrave MV1, përcakton vlerën transaksionale të mallrave të eksportuara për në Kosovë. Mallrat gjatë rrugëtimit të tyre nga furnitori jashtë vendit e deri në Kosovë, mund të shiten disa herë me çmime të ndryshme, por për t’u pranuar vlera transaksionale, nën kushte “ceteris paribus” duhet dokumentuar “shitjen e fundit në zingjirin komercial për eksportin e mallit”<sup>34</sup> për Kosovë.

Renditen kushtet nën të cilat një vlerë malli mund të konsiderohet vlerë transaksionale për t’u vlerësuar sipas metodës MV1. Trajton mundësinë kur blerësi dhe shitësi janë në lidhje të afërta. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që transaksioni të mos pranohet kur pas shqyrtimit të rrethanave të shitjes, pranohet vlera me kusht që lidhja të mos ketë ndikuar çmimin e transaksionit.

Kur mbi bazën e të dhënave dhe informacioneve të doganës, dogana ka arsye të dyshojë, këtë ia komunikon importuesit dhe i jep mundësinë për t’u përgjegjur. Me kërkesë të importuesit, arsyet i komunikohen me shkrim.

<sup>33</sup> Act 1901, Custom valuation, 2011 <https://www.abf.gov.au>

<sup>34</sup> Komisioni Evropian Taxud /800/200-EN Bruksel

Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33 metodës së vlerës transaksionale MV1, atëherë ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të metodave:

- metodës së vlerës transaksionale të mallrave identike (MV2), neni 34.2a
- metodës së vlerës transaksionale të mallrave të ngjashme (MV3), neni 34.2b
- metodës së çmimit për njësi (MV4), neni 34.2c
- metodës së vlerës së përlogaritur (MV5), neni 34.2d

Kodi jep alternativat e përdorimit të vlerës transaksionale të mallrave identike, të ngjashme, vlerës së mallrave me çmim për njësi dhe vlerës së përlogaritur. Vetëm në rastin kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet në bazë të një metode të caktuar, lejohet të aplikohet metoda që vjen në rradhë menjëherë pas saj.

“Kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 33 ose 34, do të përcaktohet në bazën e të dhënave të disponueshme në Kosovë, duke përdorë metoda të arsyeshme në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme:

- Marrëveshjen për Implementimin e Nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifatat dhe Tregtinë e vitit 1994;
- Nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifatat dhe Tregtinë e vitit 1994:
- Dispozitave të këtij kreu”<sup>35</sup>

Sipas metodës MV6, asnjë vlerë doganore nuk mund të përcaktohet mbi bazën e:

- Çmimit të shitjes së mallrave të prodhuara në Kosovë
- Pranimin e vlerës më të lartë midis dy vlerave alternative
- Çmimit të mallrave në tregun vendor të vendit eksportues
- Kostos së ndryshme të prodhimit nga mallrat identike apo të ngjashme
- Çmimeve për eksport në një vend tjetër nga ai i Kosovës
- Vlerave doganore minimale
- Vlerave arbitrare ose fiktive.

Neni 36, përfshinë elementet që duhet shtuar vlerës transaksionale të mallit, për përcaktimin e vlerës doganore të tij. Elementet që duhet shtuar, deri në masën që e kanë ngarkuar blerësin e mallit por nuk janë përfshirë në vlerën transaksionale të mallit. Ndërsa neni 37, përfshinë elementet që nuk duhet shtuar vlerës transaksionale të mallit, për përcaktimin e vlerës doganore, me kusht që të jenë të shprehura veçmas prej vlerës transaksionale të mallit.

Kodi rregullon edhe qështjen e valutës së mallit. “Kur elementet e përdorura për përcaktimin e vlerës doganore të mallrave shprehen me valutë tjetër nga ajo e euros, do të përdoret kursi i këmbimit i shpallur nga autoritetet kompetente për këtë çështje”<sup>36</sup>

---

<sup>35</sup> KDA, neni 35.1

<sup>36</sup> KDA, neni 39



## 4. Metodatat e vlerësimit të mallit

### 4.1 Metoda-vlera faturale apo vlera e transaksionit

Procedura e vlerësimit doganor, fillon me aplikimin e metodës së parë, metodës sipas vlerës transaksionale MV1, sipas nenit 33 të KDAK-së. Sipas kësaj metode, përcaktohet vlera transaksionale e çmimeve të mallrave vërtetë të paguara apo të pagueshme, të shitura për eksport në Kosovë.

Kjo duhet përshtatur sipas nevojës me elementet që duhet shtuar, apo elementët që nuk duhet shtuar vlerës doganore të mallit, me kusht që blerësi nuk ka kufizime për disponim dhe shfrytëzim të mallit sipas kërkesave të ligjit apo të autoriteteve publike të Kosovës dhe kur blerësi dhe shitësi nuk janë në lidhje të afërta mes vehte.

Fakti se personat janë në lidhje apo janë anëtarë të të njëjtës familje nuk do të thotë se vlera transaksionale nuk do të pranohet. Ky fakt, do të bëjë që zyrtari i vlerësimit me kujdes t'a analizojë dokumentacionin e mallit dhe të dhënat tjera nga sistemet operative.

Pas analizimit të indikatorëve të ndryshëm, vendosë mbi pranueshmërinë së vlerës transaksionale të mallit.

Vlerësimi doganor i mallit është procedurë komplekse. Është e domosdoshme njohja e thellë e të gjitha procedurave dhe regjimeve doganore, sepse vlerësimi i mallit, e me këtë edhe pranimi i deklaratës unike doganore (dud), sjellin efekte fiskale e mund sjellin edhe pasoja ligjore, për subjektet në procedure dhe për vlerësuesin e mallit.

Duke qenë se bota po shënon ritme të shpejta të zhvillimit ekonomik, tekniko-teknologjik, kjo reflektohet edhe në tregtinë ndërkombëtare të mallrave që nga porositë e mallit (konvencionale dhe on-line), forma dhe mënyra të reja pagesash malli (e-banking, surrogate monetare, virtuale).

Me plasimin e produkteve të reja, kostos së ulët të produkteve dhe shumëllojshmërisë së tyre, produkteve me përdorim të dyfishtë dhe atyre me rrezikshmëri të lartë, produkteve me vlera të larta, nevojitet njohje e thellë mallrash e qasje në trendet zhvillimore, njoftim në vazhdimësi me praktikatat doganore dhe bashkëpunim me administratat doganore të vendeve për ngritjen e performancës në vlerësim doganor të mallrave.

Vlerësimi bëhet, mbi bazën e fakteve të prezentuara nga dokumentacioni përcjellës i mallit. Bëhet analizë sipas indikatorëve të ndryshëm, informacioneve e të dhënave nga sektorë të brendshëm të doganës. Sistemet operative Asycuda dhe Cognos, japin informacione të vlefshme për historikun e çmimeve të mallrave të importuara.

Dogana e Kosovës, aplikon sistemin "pa letër" (paper less) të zhdoganimit të mallit, pa prezentim të kopjes fizike të lëndës.

Prezentimi i dokumenteve, nënkupton bashkangjritjen e tyre lëndës në sistemin operativ. Të gjitha dokumentet e mallit dhe fotografitë e tij bashkangjiten në sistemin operativ, në të cilin zyrtarët e pranimit dhe vlerësimit të mallit kanë qasje për punë. Të domosdoshme me rastin e deklarimit të mallit për zhdoganim, janë fatura e mallit dhe deklarata mbi vlerën-formulari D.V.1.

Mallin e shoqërojnë dokumente të ndryshme, si:

- Fatura e mallit me të dhënat e nevojshme të furnitorit, blerësit dhe mallit
- Kontrata e mallit me të dhënat mbi palët kontraktuese dhe mallin, datën, kushtet e dërgesës, valutën, kursin valuator, mënyrën e pagesës, dinamikën e furnizimit, zbritjet etj. Për shfrytëzimin e disa procedurave doganore për lirim të mallit, kontrata duhet të jetë e noterizuar.
- Urdhërpagesat e mallit
- Dokumentet mbi origjinën e mallit EUR-1

Me vendet me të cilat Republika e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje preferenciale, malli me origjinë nga këto vende, gëzon trajtimin preferencial për të cilën reduktohet ose hiqet fare taksa doganore. Këto dokumente, janë certifikata të formës së caktuar dhe janë saktësisht të precizuara me rregullat e origjinës dhe marrëveshjes preferenciale.

Për mallrat të cilët e gëzojnë origjinën preferenciale, mundet që në faturë të shënohet deklarata fature në përputhje UA 11/2009, pa dokumentin EUR-1. Kontrollohet me kujdes sepse ka efekt të madh në taksën doganore. Në rast dyshimi, inicohet verifikimi i saj përmes Sektorit të Origjinës, te autoritetet doganore të vendit që ka e lëshuar. Nëse kthehet përgjegje nga autoritetet doganore të atij vendi se dokumenti nuk është autentik, apo malli nuk i plotëson kushtet e origjinës, atëherë ndaj importuesit do të inicohet procedura administrative e kundërvajtjes apo procedura penale dhe do të inkasohen të hyrat shtesë.

- **Shembull nga praktika doganore në Kosovë:**

Importuesi E, për kohë të gjatë importonte mallin “gjedhe të gjalla,dema” nga i njëjti furnitor nga vendi eksportues K, duke deklaruar origjinën preferenciale të këtij vendi. Sipas dokumentit të origjinës, malli lirohej nga taksa doganore prej 10%.

Në një rast të vetëm, pas dyshimit në rregullsinë e dokumentit të origjinës, është inicuar procedura e verifikimit të origjinës së mallit të lartshënuar përmes Sektorit të Origjinës, pranë autoriteteve doganore të vendit eksportues K, që ka lëshuar dokumentin e origjinës. Pas një periudhe kohore, nga autoritetet doganore të vendit eksportues K, kemi marrë përgjegje se malli nuk i përmbush kushtet për origjinën preferenciale. Ndaj importuesit E, është inicuar procedura penale, sepse vlera e evazionit doganor ishte e madhe ndërsa janë inkasuar të hyrat shtesë nga taksa doganore e mallit të liruuar.<sup>37</sup>

- **Certifikata të ndryshme kualiteti**

Zakonisht, kanë të dhëna të mjaftueshme të fushave të ndryshme. Të dhëna teknike, numra tarifor, parametra të cilësisë, parametra përbërësish, kapacitetesh etj. Në bazë të këtyre të dhënave, krijohet pasqyrë më e qartë rreth kualitetit të mallit. Dogana, e ka laboratorin e vet, në të cilin mund të zhvillohen analiza dhe testime të ndryshme rreth përbërjes, cilësive dhe parametrave të tjerë të disa lloje të mallrave.

---

<sup>37</sup> Dogana e Kosovës, SKPI Aktvendim nr.05/1/183 15.04.2015

Puna e laboratorit, ka rezultuar me sukses rreth identifikimit të kualitetit të disa mallrave. Është një lidhje funksionale edhe me sektorin e tarifimit të mallit, Sektorit të Tarifës. Kjo i ka shërbyer vlerësimit doganor të mallit.

- Fletëngarkesat e mallit

Janë dokumente të transportit të mallit sipas konventave ndërkombëtare, me të cilën transportuesit marrin përgjegjësinë për dorëzimin e mallit në gjendjen siç është pranuar. Përdoren në transportin rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror. Meqenëse malli mund të shitet gjatë rrugëtimit, atëherë do të kuptohet vendngarkimi i mallit dhe në rast të mungesës së faturës së transportit, do të caktohen shpenzimet e transportit varësisht vendit të nisjes së mallit.

- Dokumente të tjera që kanë të bëjnë me vlerën e mallit

Konfirmime dhe sqarime të ndryshme nga eksportuesi, nota debiti, nota krediti, kronologji komunikimesh përmes postës elektronike etj.

#### **4.1.1 Shpenzimet që duhet shtuar vlerës transaksionale**

Vlerës transaksionale të mallit duhet shtuar të gjitha ato shpenzime që janë krijuar (nga vendi i nisjes) për mallin për eksport për në Kosovë, deri në hyrje të territorit doganor të Kosovës, “deri në masën që ato kanë ngarkuar blerësin por nuk janë përfshirë në çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat”<sup>38</sup>. Vlerës transaksionale të mallit duhet shtuar:

- **Shpenzimet e transportit të mallit**

Mallin duhet t’i shoqërojë fatura e shpenzimeve të transportit nga vendi i ngarkimit të mallit deri në vendin e destinimit në Kosovë. Nëse vlera e transportit është e ndarë veçmas, prej vendit të ngarkimit deri në pikën e hyrjes në Kosovë dhe veçmas, prej pikës hyrëse deri në vendin e destinacionit në brendi të Kosovës, dogana në vlerën e mallit duhet t’i shtojë vetëm vlerën e transportit deri në pikën hyrëse në Kosovë, ndërsa vlerën e transportit në brendi të Kosovës nuk duhet t’i shtojë.

- **Shembull nga praktika doganore në Kosovë**

Malli me paritet EXW , ngarkohet në Shkup dhe dërgohet për në Kaçanik. Në faturën e transportit, vlera e përgjithshme prej 400€ është e ndarë veçmas. Vlera e transportit prej 250€ për relacionin Shkup-Hani i Elezit dhe vlera e transportit prej 150€ për relacionin Hani i Elezit-Kaçanik. Atëherë, dogana vlerës së mallit duhet t’i shtojë vetëm vlerën e transportit prej 250€ ndërsa vlerën e transportit prej 150€ nuk duhet t’i shtojë, sepse bëhet fjalë për transport malli brenda Kosovës.

Në rast se vlera e transportit nuk është e paraqitur ndaras në faturë, atëherë në vlerën e mallit do të llogaritet vlera e transportit në tërësi, përjashtimisht, kur me kërkesën e importuesit dhe dokumentimin e tij, vlera e transportit duhet të ndahet proporcionalisht me largësinë nga vendi i ngarkimit të mallit deri në pikën hyrëse në Kosovë dhe nga pika hyrëse deri në destinacion në brendi të Kosovës.

Nëse vlera e transportit është e pa pranueshme për doganën, atëherë duhet t’i referohemi transportit të mallit të njëjtë apo mallit të ngjajshëm, nga vendi i njëjtë apo afër tij, me mjet transporti të njëjtë.

---

<sup>38</sup> KDAK, neni 36.a

Shembull, është e pa pranueshme t'i referohemi vlerës së transportit të mallit “gëlqere e shuar” ndërsa malli që vlerësohet është “ mish i bardhë pule, i ngrirë” që transportohet me maune frigorifer. Nëse nuk gjenden të dhënat e kërkuara, atëherë duhet referuar UA nr.06/2015 për shpenzimet e transportit të mallrave të importuara.

- **Shembull nga praktika doganore në Kosovë**

Importuesi M, ka kontratë me transportuesin SH, për transport malli nga Tirana në Prishtinë për çmimin prej X€ për maune. Importuesi, sipas kontratës, i paguan transportuesit përmes transaksionit bankar X€ (avans/maune), posa malli të ngarkohet në Tiranë. Transportuesi, posa të hyjë në terminalin doganor në Prizren, i dorëzon shpedicionit një kopje të faturës së transportit prej X€. Importuesi, për tri vitet e punës ka realizuar disa importe dërgesash të tilla.

Me rastin e deklarimit të mallit për zhdoganim, shpedicioni duke e llogaritur se në rast se mungon fatura e transportit, për doganën është e pranueshme vlera e transportit më e ulët se ajo e transportit real, e deklaron mallin me vlerë më të ulët transporti, e jo me vlerën faturale të transportit prej X€. Pas indikacioneve, transportuesit SH, nga dogana i bëhet një vizitë kontrolli pas dokumentare, pa paralajmërim në selinë e tij. I merren për kontrollë detale të gjitha faturat e lëshuara të transportit, të realizuara për periudhën tri vjeçare për të gjithë klientët e tij.

Pas krahasimit të faturave, transaksioneve bankare dhe vlerave të transportit të deklaruara nga shpedicioni, u konstatua se shpedicioni nuk i ka deklaruar saktë shpenzimet e transportit të mallit. Ndaj importuesit M, është inicuar kundërvajtja administrative doganore dhe janë inkasuar të hyrat shtesë nga diferenca e vlerës së shpenzimeve të transportit.

Një lloj është vepruar edhe me të gjithë klientët tjerë të transportuesit SH, te të cilët është konstatuar deklarim jo i saktë i shpenzimeve të transportit. Janë inkasuar shuma të mëdha të të hyrave shtesë. Nga kontrolli pas dokumentar, nuk u gjetën parregullsi te transportuesi SH. (“Referencë Dogana e Kosovës, SKPI Aktvenimi nr.05.1/105 dt.15.04.2015”<sup>39</sup>)

Është synim i doganës, që importuesit t'i deklarojnë realisht shpenzimet e transportit dhe shpenzimet e tjera të mallit që janë bërë jashtë territorit doganor të Kosovës. Në vlerën e shpenzimeve të transportit hyjnë të gjitha pagesat e realizuara jashtë Kosovës për mallin që vlerësohet.

- Shpenzimet e sigurimit
- komisionet e shitjes, provizionet për ndërmjetësime, shpenzimet e trajtimit deri në pikën hyrëse në Kosovë.

---

<sup>39</sup> Dogana e Kosovës, SKPI Aktvenimi nr.05.1/105 dt.15.04.2015

### **4.1.2 Shpenzimet që nuk shtohen në vlerën transaksionale të mallit**

“Me kusht që të jenë të shprehura veçmas prej çmimit vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e importuara, në vlerën doganore nuk do të përfshihen elementet e mëposhtëm”<sup>40</sup> duke renditur:

- shpenzimet e transportit të mallrave pas arritjes së tyre në vendin e paraqitjes në Kosovë
- taksat që paguhen në Kosovë
- taksat e paguara në vendin eksportues apo të origjinës, nëse importuesi përfiton prej lirimit
- lirimet, zbritjet, rabatet, dividendat, komisionet e blerjes etj.

### **4.2 Metoda-vlera e transaksionit të mallit identik**

Është metoda e dytë (MV2) e vlerësimit doganor, neni 34.2.a, KDAK. Nëse vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas metodës së parë MV1, atëherë përcaktohet sipas kësaj metode. Dogana, i referohet vlerave transaksionale të mallrave identike, të eksportuara në Kosovë në të njëjtin nivel komercial dhe sasiar, në të njëjtën kohë apo afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që janë duke u vlerësuar. Bazohet në vlerën e mallrave, të cilat janë pranuar (vlerësuar) sipas metodës MV1.

Duhet marrë parasysh dallimet mes shpenzimeve të transportit, në referencat e çmimit me paritet EXW apo DAT. Referencat në vlerat e mallrave të periudhave afërta kohore, ofrojnë siguri për lëvizje sa më të vogla çmimesh.

Mallrat identike janë “mallrat e prodhuara në të njëjtin vend, të cilat janë identike në çdo pikëpamje duke përfshirë edhe karakteristikat fizike, cilësinë dhe reputacionin. Ndryshime të vogla në pamje nuk përbëjnë shkak për t’u konsideruar jo identik”<sup>41</sup>.

### **4.3 Metoda-vlera e transaksionit të mallit të ngjajshëm**

Është metoda e tretë (MV3) e vlerësimit doganor, neni 34.2.b, KDAK. Nëse vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas metodës MV1 dhe MV2, atëherë do të përcaktohet sipas kësaj metode. Dogana, i referohet vlerave transaksionale të mallrave të ngjajshme, të eksportuara në Kosovë në të njëjtin nivel komercial dhe sasiar, në të njëjtën kohë apo afërsisht në të njëjtën kohë me mallrat që janë duke u vlerësuar.

Me rastin e referimit në vlerat e mallrave të ngjajshme të pranuar sipas metodës MV1, dogana duhet të marrë parasysh çmimin e mallit sipas paritetit EXW apo DAT.

Mallrat e ngjajshme, janë mallrat e prodhuara në të njëjtin vend, nuk janë identike në çdo pikëpamje, kanë karakteristika dhe përbërje materiale të ngjajshme, kanë të njëjtat funksione ndërsa nga aspekti komercial janë të ndërrueshme, të këmbyeshme mes vehte.

---

<sup>40</sup> KDAK, nei 37

<sup>41</sup> UA 11/2009, neni 61.c

#### 4.4 Metoda-çmimi për njësi

Rregullat e vlerësimit të mallit, obligojnë doganën për përdorimin e metodave sipas renditjes kronologjike (hierarkike). Metoda e katërt (MV4) e vlerësimit neni 34.2.c, KDAK, përdoret nëse malli nuk mund të vlerësohet sipas metodave MV1, MV2 dhe MV3. Mirëpo, me kërkesën e importuesit, para kësaj metode mund të përdoret metoda e pestë e vlerësimit, metoda e përlogaritjes MV5.

Sipas kësaj metode, vlera doganore bazohet në çmimin për njësi të mallrave identike dhe mallrave të ngjajshme, të shitura “jo më larg se pas 90 ditësh nga data e importit”<sup>42</sup> në tregun me shumicë në Kosovë, në sasinë më të madhe agregate (të përgjithshme), në gjendjen siç janë importuar, me kusht që personat që marrin pjesë në shitje, nuk janë në lidhje me shitësin. Kodi lejon zbritjet si:

- përqindjet e komisionit
- shpenzimet e transportit, sigurimit dhe shpenzimet tjera të krijuara në Kosovë
- detyrimet doganore në import dhe pagesat tjera të pagueshme në Kosovë për qëllime importimi apo të shitjes së mallrave.

Nëse mallrat e importit janë shitur pas përpunimit të tyre, atëherë duhet të zbritet vlera e shtuar në Kosovë, prej procesit të përpunimit.

Për konstatimin e çmimit për njësi të mallrave të importit të shitura në sasinë agregate më të madhe, dogana bazohet në nivelin e parë komercial (shitjet me shumicë), ndërsa personi duhet të jetë në gjendje të jep detajet e shitjeve të realizuara. Detajet, ofrohen përmes faturave të shitjes, një çmimoreje të momenti të shitjes, ndonjë dëshmie tjetër e pranuar (dakorduar paraprakisht) nga dogana.

#### Shembull:

Një depo malli më shumicë, shet libra. Në hyrje të depos, ka të publikuar listën me çmime të ndryshme të librave si në tabelë. Për t'u shkarkuar me pazarin ditor, deri në fund të orarit të punës, shitësi ka regjistruar këto shitje:

Sasia e shitur në copë	Çmimi €/copë	Shitje e realizuara	Sasia e përgjithshme e shitur në copë
1 deri 50	1€	10 shitje nga 12 copë 15 shitje nga 6 copë	210
51 deri 100	0.9€	5 shitje nga 60 copë 4 shitje nga 65 copë	560
Mbi 100	0.85€	4 shitje nga 120 copë	480

Tabela nr.4.4.1 Regjistrim i shitjeve në sasi agregate më të madhe

Siç shihet nga tabela, numri më i madh i shitjeve të realizuara është 560 copë, ndërsa i korrespondon çmimi prej 0.9€/copë. Si rrjedhim, nga çmimi prej 0.9€, nga dogana do të bëhen zbritjet e lartshënuara dhe do të fitohet çmimii i mallit për zhdoganim.

<sup>42</sup> UA 11/2009, neni 71.2

## 4.5 Metoda-vlerës së përllogaritur

Metoda e pestë (MV5), metoda e vlerës së përllogaritur, neni 35.2.d, gjenë zbatim të rrallë. Nga praktika doganore, është ndër metodat që më së paku është aplikuar për vlerësim mallrash. Zakonisht përdoret kur eksportuesi dhe importuesi janë në lidhje. Vështirësitë e vlerësimit sipas kësaj metode, rrjedhin nga fakti se duhet gatishmëri që prodhuesi i mallit jashtë Kosovës, t'i ofrojë doganës specifikacionin mbi normativat e prodhimit të mallit që vlerësohet dhe shpenzimet e krijuara për prodhimin e tij.

Ndërsa, dogana nuk ka mekanizëm që e detyron prodhuesin për plotësimin e kësaj kërkesë. Vetëm kur, Dogana e Kosovës pas njoftimit të autoriteteve kompetente të vendit të prodhuesit dhe në pajtim me prodhuesin mund t'i verifikojë këto të dhëna. Megjithatë, kjo metodë mund të përdoret para metodës së vlerës për njësi MV4 (me kërkesën e importuesit) dhe kur malli nuk mund të vlerësohet sipas metodave MV1, MV2 dhe MV3. Vlera voganore sipas kësaj metode është vlerë "e ndërtuar", sepse bazohet në përllogaritjen e të gjitha shpenzimeve të krijuara për prodhimin e produktit, nga lënda e parë e deri në finalizimin e tij për shitje, me paritet EXW apo DAT.

Vlera përcaktohet duke llogaritur shumën nga :

- vlera e shpenzimeve për materialet përbërëse, vlerën e fabrikimit ose proceseve tjera të përdorura për prodhim, shumën e fitimit dhe shpenzimeve të përgjithshme, shpenzimet e transportit, sigurimit ose vlera e të gjithë elementeve që i shtohen vlerësimit sipas metodës së parë MV1.

Të dhënat që ofrohen nga prodhuesi, duhet të jenë të bazuara në llogaritë komerciale dhe të bazuara në principet e përgjithshme të kontabilitetit, që aplikohen në vendin e prodhimit të mallit. Në rast, të pamundësisë për ofrimin e të dhënave të nevojshme nga prodhuesi, dogana aplikon metodën e vlerësimit të çmimit për njësi MV4 (nëse është kaluar renditja kronologjike e aplikimit të metodave) apo metodën e të dhënave të disponueshme MV6 (nëse nuk është kaluar renditja kronologjike e aplikimit të metodave).

## 4.6 Metoda-të dhënat e disponueshme

Është metoda e fundit që mund të përdoret për vlerësim doganor të mallrave. Kur vlera e mallrave nuk mund të përcaktohet sipas metodave MV1 deri MV5, atëherë aplikohet metoda e gjashtë e vlerësimit MV6, të dhënat e disponueshme neni 35, KDAK, të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës. Vlerësimi sipas kësaj metode, bëhet në përputhje me parimet dhe rregullat e nenit 7 të OBT-së.

Të dhënat e disponueshme, përditësohen nga Sektori i Vlerës, ndërsa mirren nga burime të ndryshme informacioni. Mbi bazën e UA 67/2009, të dhënave prej moduleve të krijuara nga dogana, të dhënave nga analiza prej sektorëve të doganës, katalogjeve fizike, katalogjeve on-line, të dhënave nga sistemet operative, sipas kësaj metode dogana vlerëson edhe mallrat e përdorura si automjetet, makineri të rënda pune, mallra amvisërie, veshëmbathje, dërgesa të përziëra etj.

Sipas metodës MV6 vlerësohen mallrat e dëmtuara dhe mallrat që vijnë nga hapsira gjeografike me rrezikshmëri të lartë, pemët dhe perimet, mallrat që janë në bursën ndërkombëtare etj. Pemët dhe perimet janë produkte sezonale. Vlerësimi i tyre bazohet në të dhënat e disponueshme të cilat freskohen çdo javë.

## 5. Sfidat e vlerësimit të mallit

Procedura e vlerësimit doganor të mallit, siç është shënuar më lartë kërkon përgaditje të thella rreth njohjes së mallrave të fushave të ndryshme. Duket se nuk është vetëm procedurë (proces) në kuptimin klasik. Lehtësimi i tregtisë dhe transportit ndërkombëtar të mallrave përmes eliminimit të barrierave të ndryshme jo tarifore, solli produkte ndërkombëtare markash të ndryshme më shpejtë e më afër blerësit potencial. Në këtë kuptim, oferta e madhe për produkte të reja nga njëra anë dhe mundësitë potenciale për plasim produktesh të reja në tregje nga ana tjetër, doganën e sjellin para domosdoshmërisë së përcjelljes me kujdes të shtuar, të trendeve bashkohore në fushën e vlerësimit doganor të mallit.

Importimi i produkteve e shërbimeve të reja në treg, e me këtë nevoja për vlerësim doganor nga fusha e teknologjisë informative, jo rrallë herë, për doganën kanë shfaqë arsyen për trajtim malli me kujdes të shtuar. Produktet e teknologjisë informative, me përmasat, kapacitetet, funksionet dhe mundësitë e shumta opcionale, kanë rritur dyshimin lidhur me klasifikimin tarifor të mallit e rrjedhimisht edhe me vlerësimin e tyre. Ndihmë e madhe për vlerësuesit doganor të mallit iu është dhënë nga sektori i tarifimit të mallit.

Janë të shpeshta importet, kur sistemi operativ sinjalizon vlerësuesit e mallit mbi mallrat me përdorim të dyfishtë. Edhe pse këto mallra, në deklaratën eksportuese të tyre e kanë të shënuar shifrën mbi përdorimin e tyre të dyfishtë, ndodhë që me apo pa qëllim të mos ketë malli deklaratë eksportuese. Pos rrezikut të mundshëm lidhur me përdorimin, këto mallra zakonisht kanë vlera malli të larta.

Për këto raste dyshimi, nevojitet konfirmimi nga sektorë përgjegjës nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Qeverisë së Kosovës. “Doganat e Kosovës janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e eksportit aktual, importit, transitit, ngarkimit apo ndonjë procedurë tjetër doganore që lidhet me mallrat strategjike dhe për vlerësimin e përputhjes së mallit me licencën e lëshuar.”<sup>43</sup>

**Mallrat nga vendet aziatike “me rrezikshmëri të lartë Kina, Dubai, Turqia”<sup>44</sup>**, sistemi operativ zakonisht i kanalizon për analizë dokumentare me mundësi potenciale për parregullsi, për vlerë faturale, klasifikim tarifor, mallra të përdorimit të dyfishtë etj. Në raste të shpeshta, malli për arsye të ndryshme, përveq faturës dhe fletëngarkesës detare ose rrugore nuk ka dokumente të tjera. Kjo shkakton vonesa dhe dyshime për përcaktimin sa më real të vlerës së mallit.

Vlerësimin e automjeteve dhe makinerive të rënda të përdorura, dogana e bazon në të dhënat e disponueshme. Duke disponuar me katalogje fizike për vlerësim, me katalogje on-line, qasje në të dhëna të ndryshme në internet e burime të të dhënash të tjera, dogana përcakton vlerën e tyre, varësisht specifikave teknike të tyre. Jo rrallë herë, dogana përcakton vlerën e tyre duke zbritur përqindje të caktuara nga çmimi i tyre, për dëmtimet e tyre të ndryshme që kanë pësuar.

---

<sup>43</sup> Ligji për Tregtinë e Mallrave Strategjike nr.04/L-198, neni 26

<sup>44</sup> UA 67/2009, 27.04.2009



Kjo bëhet, në bazë të raporteve për vlerësimin e dëmtimeve (të karrocerisë) nga komisionet e krijuara të doganës. Është në trend rritës, dukuria e importit të përkohshëm për automjetet e dëmtuara nga vendet e perëndimit për riparim në Kosovë, për shkak të kostos së ulët të riparimit. Kjo paraprakisht kërkon, vlerësim të dëmit, e pastaj përcaktim të vlerës doganore të automjetit, në mënyrë që të llogaritet shuma e garancionit të nevojshëm, për importin e përkohshëm të automjetit.

Ngjajshëm veprohet edhe me makineritë e rënda të cilat vijnë për arsye të zhvillimit të punimeve të ndryshme në vend dhe përsëri kthehen mbrapa. Kjo realizohet nën procedurën doganore të importi të përkohshëm. Nevojitet përcaktim i vlerës doganore sepse pas përfundimit të punimeve, makineritë mund të shiten në tregun e Kosovës, sipas vlerës që kanë hyrë, ndërsa mund të ndodhë nënvlerësimi fatural. Poashtu, nga vlera doganore varen edhe detyrimet doganore që duhen paguar, për importin e përkohshëm me lirim të pjeshëm.

Kjo shton nevojën për përcaktimin e shumës së garancionit bankar. Vlerësimi i mallit bëhet sipas metodës së gjashtë MV6. Mallrat e përdorura, për përdorim të gjerë (jo ushqimore) deklarohen me të metat dhe dëmtimet që i kanë. Mund të ndodhë, që në vend të mallrave të reja, deklarimi të bëhet për mallra të përdorura në mënyrë që të përfitohet nga zbritjet e arsyeshme që lejohen për mallrat e përdorura. Zakonisht, janë dërgesa mallrash të përziera, jo të strukturuar mirë, të faturuara në grup. Nevojitet përcaktim vlere dhe ndarje proporcionale e shpenzimeve të transportit.

Në rast të pamundësisë së vlerësimit për arsye të të dhënave jo të plota, vlera përcaktohet pas verifikimit të komisionit të krijuar, sipas raportit me shkrim. Të gjithë mallrat e përdorura, vlerësohen sipas metodës së gjashtë MV6, me parite EXW.

Mallrat e ndryshme që gjenden në bursën ndërkombëtare, zënë vend të theksuar në strukturën e importit të mallrave për Kosovë. Është obligim i Sektorit të Vlerës, që modulën e vlerës së krijuar për klasifikimin dhe renditjen e të dhënave të disponueshme, çdo dy javë t'a freskon me të dhëna rreth lëvizjes së çmimeve për produktet ushqimore, metalet dhe mallra të tjera.

Të dhënat e freskuara (përditësuara) i referohen bursës së mallrave Reuters. Përcaktimi i vlerës së mallrave nga bursa ndërkombëtare, bëhet sipas metodës së gjashtë MV6, duke u bazuar në të dhënat e disponueshme të datës së njëjtë, sikur data në faturën e mallit të deklaruar për zhdoganim.

## **5.1 Deklarata e vlerës-formulari D.V.1**

Fatura e mallit dhe deklarata e vlerës D.V.1, sipas kodit janë dokumentet e domosdoshme që e shoqërojnë dudin. Kjo deklaratë përpilohet në formularin D.V.1, varësisht numrit të emërtimeve të dudit. Është deklaratë për të dhëna mbi vlerën e mallit të importuar. Deklarata D.V.1, është e obligueshme për t'u plotësuar kur vlera doganore e mallit tejkalon shumën prej 10000€, përveçq rasteve kur:

- “malli është i karakterit jo komercial
- malli lirohet nga pagesa
- importuesi aplikon procedurën e thjeshtëzuar”<sup>45</sup>

---

<sup>45</sup> UA 11/2009, neni 89.1

Personi i nënshkruar në deklaratën D.V.1, “është përgjegjës për:

- saktësinë dhe kompletimin e të dhënave të deklaratës
- autenticitetin e dokumenteve të ofruara për të mbështetur ato të dhëna
- dorëzimin e të gjitha të dhënave shtesë dhe të dokumentacionit të nevojshëm për përcaktimin e vlerës doganore të mallit.”<sup>46</sup>

Për mallin, vlera doganore e të cilit përcaktohet sipas nenit 34 apo 35 të KDAK-së, çdo herë lëndës duhet t'i bashkangjitet, Procesi i Vlerësimit të Mallit (formular standard), në të cilin jepen të dhënat mbi metodën e aplikuar me rastin e vlerësimit të mallit.

Nëse importuesi kundërshton vlerësimin doganor të mallit, ai ka të drejtë, që në afatin prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij procesi, të ushtrojë ankesë pranë Sektorit të Rishqyrtimeve të Vendimeve të Doganës së Kosovës. Në rast të mospajtitimit edhe me këtë vendim, ai ka të drejtë ankese pranë organeve gjyqësore të Republikës së Kosovës.

Vlerësimi doganor, duhet të bëhet vetëm mbi bazën e fakteve dokumentare dhe të gjendjes së mallit me rastin e deklarimit për zhdoganim, që do të ulte numrin e aneksave. Në të kundërtën, ankesa eventuale e importuesit, mund t'i arrijë instancat më të larta gjyqësore të vendit.

## **6. Reflektimi i vlerësimit të operatorët ekonomik-raste studimore nga njësitë kërkimore<sup>47</sup> (problematikë e shtruar nga anketuesit)**

Duke trajtuar metodat e vlerësimit doganor të mallit, kemi vërejtur dallimet gjatë aplikimit të tyre. Përpos metodës transaksionale, aplikimi i metodave alternative përcjellat me efekte që shkaktojnë rritjen e shumës së detyrimeve doganore. Këto efekte, të rritjes së detyrimeve për pagesë nga ato të pranuar sipas vlerës transaksionale të mallit, përcjellen edhe te importuesi i mallit apo te operatori ekonomik.

Në disa raste, mospranimi i vlerës transaksionale dhe zhdoganimi sipas metodave alternative (MV2 deri në V6), e detyron operatorin të bëjë rregullimet dhe përshtatjet e nevojshme në shënimet e kontabilitetit. Vlerësimin doganor të mallit ATK e merr për bazë, pikë referimi për mallrat nga importi për tatimim. Në këtë kuptim, vlerësimi doganor trajtohet gjatë kontrollave të ndryshme të operatorëve, të agjensioneve të ndryshme kompetente në vend.

Vlerësimi doganor i mallit, duke abstrahuar arsytet tjera, bëhet që t'i ofrojë kushte të barabarta konkurrence lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve. Pavarësisht se operatorët ekonomik, mund të furnizohen me mall me çmime më të ulëta (malli mund edhe të falet) se konkurrenca, dogana në bazë të obligimeve, siç është shkruar deri më tani, mbanë ekuilibrin mes importeve të mallit. Vlerësimi doganor i mallit (përveq metodës MV1), përcjellat me diferencë pagesash të detyrimeve doganore, varësisht nga vlera e mallit, norma tarifore, klasifikimi tarifor e masat tjera.

Në momentin kur kontestohet vlera e mallit, rrjedhimisht do të ketë edhe ndryshime në llogaritjen e taksave doganore. Ndryshime ka bërë edhe ATK në kuptimin se deri me datën 02.06.2016, shtesën e vlerësimit nga dogana e ka pranuar si kosto malli, ndërsa pas kësaj date, kjo nuk është konsideruar e tillë sipas vendimit nr.3/2016.

<sup>46</sup> UA 11/2009, neni 88.4

<sup>47</sup> R.Livoreka “Kërkim marketingu”, Prishtinë 2011

Kjo nuk konsiderohet kosto malli sepse nuk është vlerë e paguar. Ndërsa “sasia e parave që paguan një kompani për të blerë një makinë përbën koston e makinës (vlerën furnizuese të saj)”.<sup>48</sup> Me shembujt në vazhdim do t’a analizojmë shtesën doganore nga prizmi i një importuesi. Këto vërejtje i kanë shfaqur dhe prezentuar të anketuarit me rastin e plotësimit të pyetësoreve, për qëllime të këtij punimi.

### Shembull nr.1

Është importuar malli me vlerë faturale 12000€ me paritet DAT. Malli pranohet me MV1, zhogonohet duke paguar taksën doganore 10% dhe TVSH 18%. Shitet menjëherë në terminalin doganor, me diferencë vlere prej 500€. Llogarisim taksat:

Normat e taksave	Baza doganore	Shuma e taksës
10%	12000€	1200€
18%	13200€	2376€
Për pagesë		3576€

Tabela nr.6.1

Malli për pagesë ka detyrimet sipas tabelës. TVSH në import është TVSH e zbritshme ndërsa në brendi është TVSH e llogaritur. Kur malli pas zhdoganimit shitet me një vlerën të shtuar prej 500€ (si më lartë), atëherë në vlerën e mallit të shitur (13200€+500€) do të llogaritet TVSH për pagesë, pra  $13700€ \times 18\% = 2466€$ . Duke zbritur (TVSH e llogaritur) - (TVSH e zbritshme), fitojmë:  $2466€ - 2376€ = 90€$ . Shuma prej 90€ mbetet të paguhet dhe të deklarohet në ATK me deklaratë (apo  $500€ \times 18\% = 90€$ ). Tani, duke lënë mënjanë TVSH-në, kemi:

Të hyrat nga malli	13700€
KMSH	- 13200€
Fitimi bruto	500€
Tatimi në fitim 10%	-50€
Fitimi neto 10%	450€

Tabela nr.6.1a

Pra, kosto reale e mallit është kosto e mallit të shitur 13200€ (12000€+1200€). Malli ka paguar shumën 1200€ për taksë doganore, ndërsa shumën prej 50€, e ka obligim për tatimin në fitim, t’a paguan dhe ta deklaron në ATK. Rasti kur shtesa doganore nga vlerësimi pranohej nga ATK si kosto: Shembulli nr.2

Malli vlerësohet me MV6, i shtohen 3000€ nga vlerësimi doganor. Pas zhdoganimit, malli shitet në terminalin doganor me diferencë vlere prej 500€. Llogarisim taksat.

Përshkrimi	Vlerat në €
Vlera faturale	12000
Shtesa doganore MV6	3000
Baza doganore	15000
10% dogana	1500
Vlera perlllogaritare me dogane shtese	16500
Diferencë në shitje	500
Të hyrat	17000

<sup>48</sup> R.Osmani “Kontabiliteti Menaxherial për Biznes” fq.49, Tetovë 2011

Tabela nr.6.2

Tani, duke lënë mënjanë TVSH-në, kemi:

Të hyrat nga malli	17000€
KMSH	- 16500€
Fitimi bruto	500€
Tatimi në fitim 10%	-50€
Fitimi neto	450€

Tabela nr.6.2a

Pra, në koston e mallit 16500€ (12000€+3000€+1500€) është pranuar edhe shtesa doganore nga vlerësimi. Malli ka paguar shumën 1500€ për taksë doganore, ndërsa shumën prej 50€, e ka obligim për tatimin në fitim, t'a paguan dhe ta deklaron në ATK. Tani, dallimi qëndron mes shembullit nr.1 dhe shembullit nr.2. Meqë sipas shembullit nr.2, mallit i është ngritur baza doganore për 3000€, rrjedhimisht do të paguan detyrime për taksën doganore për 300€ më shumë apo do të paguan më shumë, për 10% në shtesën doganore (10% x 3000€).

Pas vendimit nga ATK<sup>49</sup> për mospranimin e shtesës doganore si kosto malli, situata ndryshon (te malli që i ngritet vlera faturore), duke bërë që importuesi të paguan më shumë për taksën doganore dhe tatimin në fitim, si në shembullin 3 dhe 4.

Rasti kur shtesa doganore nga vlerësimi nuk pranohet nga ATK si kosto: Shembulli nr.3  
Mallit pranohet me MV1, nuk i rritet vlera faturale. Malli shitet me diferencë vlere prej 500€.

Përshkrimi	Vlerat në €
Vlera faturale	12000
Baza doganore	12000
10%	1200
Vlera perlogaritare me dogane shtese	13200
Diferencë në shitje	500
Të hyrat	13700

Tabela nr.6.3

Tani, duke lënë mënjanë TVSH-në, kemi:

Të hyrat nga malli	13700€
KMSH	- 13200€
Fitimi bruto	500€
Tatimi në fitim 10%	-50€
Fitimi neto	450€

Tabela nr.6.3a

Pra, kosto reale e mallit është kosto e mallit të shitur 13200€ (12000€+1200€). Malli ka paguar shumën 1200€ për taksë doganore, ndërsa shumën prej 50€ për pagesë dhe deklarim në ATK.

<sup>49</sup> ATK, Vendimi nr.3/2016 02.06.2016

#### Shembulli nr.4

Malli vlerësohet me MV6, i rritet vlera faturale për 3000€. Malli shitet me diferencë vlere prej 500€.

Përshkrimi	Vlerat në €
Vlera faturale	12000
Shtesa doganore MV6	3000
Baza doganore	15000
10%	1500
Vlera perlogaritare me dogane shtese	16500
Diferencë në shitje	500
Të hyrat	17000

Tabela nr.6.4

Tani, duke lënë mënjanë TVSH-në, kemi:

Të hyrat nga malli	17000€
KMSH	- 13500€
Fitimi bruto	3500€
Tatimi në fitim 10%	350€
Fitimi neto	3150€

Tabela nr.6.4a

Pra, në koston e mallit 13500€ (12000€+1500€), shtesa doganore prej 3000€ nuk është pranuar. Malli ka paguar shumën 1500€ për taksë doganore, ndërsa shumën prej 350€, e ka obligim për tatimin në fitim, t'a paguaj dhe ta deklarojë në ATK. Tani, dallimi qëndron mes shembulli nr.3 dhe shembullit nr.4.

Meqë sipas shembullit nr.4, mallit i është ngritur baza doganore për 3000€, rrjedhimisht do të paguaj detyrime për taksën doganore më shumë se te shembulli nr.3, për 300€, pra më shumë për 10% në shtesën doganore (10% x 3000€). Meqë, shtesa nuk njihet si kosto malli sepse nuk është shumë që është paguar, ajo e rritë fitimin bruto i cili tatimohet me 10%.

Për këtë arsye importuesi do t'i paguan 350€ (10% më shumë nga shtesa doganore dhe 10% nga diferenca në shitje), në emër të tatimit në fitim. Mospranimi i shtesës si kosto malli, për t'u zbritur nga të hyrat, bën që shtesa të rrisë fitimin bruto. Malli sipas shembullit nr.4 (kur i ngritet baza doganore), do të paguan 600€ më shumë (taksë doganore dhe tatim në fitim) se në shembullin 3.

Dallimi te shembulli nr.1 dhe nr.2, ka qenë se malli me shtesë doganore ka paguar vetëm 10% më shumë në shtesën doganore se shembulli nr.1, që është pa shtesë doganore.

Ndërsa dallimet mes shembullit nr.3 dhe nr.4, janë se malli me shtesë doganore (shembulli nr.4) paguan 10% në shtesën doganore më shumë së shembulli nr.3 (malli i pranuar me MV1) dhe 10% më shumë në shumën e shtesës doganore që e rritë fitimin bruto, ndërsa nuk pranohet si KMSH. Në tërësi, rrjedh se paguan 20% të shtesës, më shumë (për taksë doganore dhe tatim në fitim në shtesën doganore).

Nga mos pranimi i shtesës në koston e mallit, do të lindin situatat kur malli nuk mund të shitet sipas vlerësimit nga dogana plus fitimi i importuesit, kur malli shitet ndërsa çmimi real nuk përkon me shitjet, situatat kur malli që shitet me çmim më të ulët se vlerësimi doganor ATK-ja nuk e pranon të kreditojë TVSH-në.

## Shembulli nr.5

Malli shitet me një diferencë çmimi prej 500€. Malli është me shtesë doganore, MV6.

Përshkrimi	Vlerat në €	TVSH
Vlera faturale	12000	
Shtesa doganore MV6	3000	
Baza doganore	15000	
10%	1500	
Vlera perlllogaritare me dogane shtese	16500	2970€ TVSH e zbritshme
Diferencë në shitje	500	
Të hyrat	17000	

Tabela nr.6.5

Tani, duke lënë mënjanë TVSH-në, kemi:

Të hyrat nga malli	17000€
KMSH	- 13500€
Fitimi bruto	3500€
Tatimi në fitim 10%	350€
Fitimi neto	3150€

Tabela nr.6.5a

Në këtë rast, nëse malli shitet me kosto reale, ai duhet të shitet 14000€, duke llogaritur: (12000€+1500€+500€). Kjo vlerë e shitjes së mallit ka 2520€ TVSH të llogaritur, ndërsa malli me rastin e zhdoganimit, ka paguar 2970€ TVSH të zbritshme. Tani kur i refundohen (thyhen mes vehte), i zbresim, rrjedh se 2520€ -2970€ = - 450€, që do të thotë se importuesi është në kreditim nga ATK-ja për 450€. Këtë ajo nuk e pranon, shembull për kamionë, me arsyetimin se malli është vlerësuar nga një institucion publik dhe nuk mund të shitet ai mall nën çmimin që ka e vlerësuar dogana.

Derisa dogana e ka vlerësuar me çmim prej 15000€+ taksa doganore prej 1500€+ 500€ diferencë çmimi, atëherë sipas ATK malli duhet të shitet 17000€, ATK në anën tjetër nuk lejon që shtesa të pranohet si kosto e mallit të shitur.

Tani, meqënëse nuk e pranon kreditimin, importuesi (obliguesi tatimor) duhet t'a faturojë mallin, derisa TVSH e llogaritur të bëhet më e madhe se TVSH e zbritshme. Kjo arrihet vetëm kur malli të faturohet mbi vlerën doganore të caktuar nga dogana.

Këtë e kofirmojnë disa nga kontabilistët e certifikuar, me rastin e pyetësorëve të dhënë. Disa nga to mendojnë se kjo duhet bartur në muajin vijues si balancë kreditore. Prej tyre ka që mendojnë se duhet faturuar deri sa TVSH e llogaritshme të bëhet më e madhe se TVSH e zbritshme.

Disa prej kontabilistëve, ndajnë mendimin se shtesat duhet të barten te pasuritë në pozicionin e rivlerësimeve sepse nuk ka kosto. Kosto definohet si" sakrificë e matshme e resurseve e këmbyer për mallra dhe shërbime"<sup>50</sup>

<sup>50</sup> R.Osmani "Kontabiliteti Menaxherial për Biznes" fq.68, Tetovë 2011

### Shembulli nr.6

Malli shitet me një diferencë çmimi prej 0€. Malli është me shtesë doganore, MV6

Përshkrimi	Vlerat në €	TVSH
Vlera faturale	12000	
Shtesa doganore MV6	3000	
Baza doganore	15000	
10%	1500	
Vlera perlogaritare me dogane shtese	16500	2970€ TVSH e zbritshme
Diferencë në shitje	0	
Të hyrat	16500	

Tabela nr.6.6

Tani, duke lënë mënjanë TVSH-në, kemi:

Të hyrat nga malli	16500€
KMSH	- 13500€
Fitimi bruto	3000€
Tatimi në fitim 10%	<u>300€</u>
Fitimi neto	2700€

Tabela nr.6.6a

Tregu sjellë situata kur malli shitet edhe pa një diferencë në vlerë. Kostoja e mallit 13500€ , nuk përfshinë shtesën doganore prej 3000€, sepse nuk është pranuar. Malli ka paguar shumën 1500€ për taksë doganore, ndërsa shumën prej 300€, e ka obligim për tatimin në fitim sipas dokumentacionit, t'a paguan dhe ta deklaron në ATK.

### Shembull nr.7

Malli shitet me një diferencë çmimi prej 3000€. Malli është me shtesë doganore, MV6

Përshkrimi	Vlerat në €	TVSH
Vlera faturale	12000	
Shtesa doganore MV6	3000	
Baza doganore	15000	
10%	1500	
Vlera perlogaritare me dogane shtese	16500	2970€ TVSH e zbritshme
Diferencë në shitje	3000	
Të hyrat	19500	

Tabela nr.6.7

Tani, duke lënë mënjanë TVSH-në, kemi:

Të hyrat nga malli	19500€
KMSH	- 13500€
Fitimi bruto	6000€
Tatimi në fitim 10%	<u>600€</u>
Fitimi neto	5400€

Tabela nr.6.7a

Në këtë rast, malli duhet të shitet 16500€ duke llogaritur: (12000€+1500€+3000€). Kjo vlerë e shitjes së mallit ka 2970€ TVSH të llogaritur, ndërsa malli me rastin e zhdoganimit, ka paguar 2970€ TVSH të zbritshme.

Tani kur i refundojmë (i thejmë mes vehte), i zbresim, rrjedh se 2970€-2970€=0€, që do të se importuesi as nuk është në kreditim e as nuk ka detyrim për pagesë shtesë të TVSH, pra kjo barazohet vetëm në këtë diferencë vlere të shitjes.

Mirëpo këtë nuk e pranon ATK , sipas së cilës për të realizuar 3000€ diferencë çmimi, ai duhet të shitet me çmim prej 19500€. Malli ka paguar shumë 1500€ për taksë doganore, ndërsa shumë prej 600€, e ka obligim për tatimin në fitim, t'a paguan dhe ta deklaron në ATK.

Tani, nëse importuesi planifikon fitimin pas tatimit prej 5400€ dhe paguan tatim prej 10%, atëherë e ardhura operuese para tatimit do të jetë 6000€, që llogaritet si vijon:

$$^{51}\text{E ardhura pas tatimit (APT)} = \frac{E \text{ ardhura operuse}}{1 - \text{Norma e tatimit në fitim}} = \frac{5400}{1 - 0.10} = 6000$$

Gjatë vizitave në teren me rastin e kontrollave doganore, sipas përgjegjeve në pyetësorët e plotësuar nga importuesite një kategorie malli, shembull importues kamionash të përdorur, vërehen ankesa lidhur me përcaktimin e vlerës doganore të tyre. Është pretendim i tyre se mallin e blejnë me çmimet e deklaruara për zhdoganim.

Kjo mbetet pretendim i tyre ndërsa dogana vazhdon trajtimin e barabartë para të gjitha palëve në procedurë. Sipas përgjegjeve të marra nga pyetësorët, kryesisht importuesit ankohen në shtesën e vlerësimit doganor, ndërsa kontabilistët në mospranimin e shtesës nga ATK-ja si kosto malli.

Vlerësimi doganor i mallit dhe mos pranimi që shtesa doganore të llogaritet në koston e mallit, ka dhënë efektet e veta pozitive, duke mbrojtur parimet për pa anshmëri, trajtim të barabartë, vlerësim mbi baza fatike, parandalim shmangiesh e evazionesh fiskale, etj.

Duket se kjo po i shtyn subjektet importuese që t'a deklarojnë mallin sipas vlerave faturale të pranueshme për doganën, si çmime që janë paguar apo është dashtë të paguhet për mallin e destinuar për eksport në Kosovë, në mënyrë që malli të vlerësohet sipas metodës transaksionale.

Vlera faturale e pranuar si vlerë doganore, në të cilën janë të paraqitura të gjitha shpenzimet të cilat janë bërë me mallin deri në hyrje të territorit doganor të Kosovës, përfaqëson në mënyrë të saktë koston reale të mallit.

Realizimi i importit të mallit nën përdorimin e metodës transaksionale, mallin do t'a zhdoganojë sipas koston së tij reale, duke mos shkaktuar komplikimet lidhur me vlerën për njësi dhe komplikimet lidhur me korigjimet dhe përshtatjet e nevojshme në të dhënat kontabile.

Duke analizuar përdorimin e metodave të vlerësimit për periudhën e viteve 2010-2018 sipas tabelës së më poshtme, rrjedh se Dogana e Kosovës për mbledhjen e të hyrave doganore të importit të rregullt, ka përdorur metodën transaksionale mesatarisht në mbi 90% të të hyrave doganore.

---

<sup>51</sup> R.Osmani "Kontabiliteti Menaxherial për Biznes" fq.191, Tetovë 2011



Viti	Metoda transaksioanle MV1	Metodat tjera
2010	89.31%	10.69%
2011	90.78%	9.22%
2012	93.35%	6.65%
2013	94.68%	5.32%
2014	89.25%	10.75%
2015	89.11%	10.89%
2016	92.83%	7.17%
2017	92.08%	7.92%
2018	92.87%	7.13%

Tabelë nr.6.8 Përdorimi i metodës transaksionale për vitet 2010-2018<sup>52</sup>

Pra, nga e gjithë shuma e të hyrave doganore, mbi 90% e tyre janë mbledhur nga aplikimi i metodës sipas vlerës transaksionale, që është në përputhje me hipotezën kryesore, e cila vlerë përfaqëson koston reale të mallit, në funksion të doganimit objektiv, mbledhjes së të hyrave dhe realizimin e planifikimeve fiskale të Republikës së Kosovës. Rritja e aplikimit të metodës transaksionale në vazhdimësi është synuar nga Dogana e Kosovës..

Vlerësimi drejtë dhe objektiv i mallit, reflekton mbledhjen e drejtë dhe objektive të të hyrave për buxhetin e shtetit.

Aplikimin e metodës transaksionale në mbi 90% të rasteve, si parim kryesor të OBT-së, qëndron në raport të drejtë me zvogëlimin e numrit të ankesave lidhur me vlerësimin e mallit.

”Me reformat e vazhdueshme, Dogana e Kosovës, ka arritur të bëjë zvogëlimin e koston për tregtinë e ligjshme duke arritur nivelin e baraspeshës adekuate ndërmjet kontrollit doganor dhe krijimit të lehtësirave tregtare, duke shfrytëzuar teknikat për vlerësimin e rrezikut dhe kontrollet selektive, bazuar në profilizimin paraprak”<sup>53</sup>.

Hipotezën ndihmëse rreth efekteve të shtesës në koston e mallit te operatorët ekonomik e kemi tesuar përmes shembujve, që për qëllime praktike janë marrë një palë të dhënash për asrye krahasimi. Kemi pasqyruar rastet kur aplikimi i metodave alternative nga ajo transaksionale, sjellë efekte të pa dëshiruara nga importuesit dhe nga mbajtësit e librave tregtar, me pasojë kostoje.

Pra efekti i drejtpërdrejtë te operatori është se në shtesën e mallit do të paguan taksën doganore, ndërsa në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, shtesa e zvogëlon koston e mallit të shitur KMSH, ndërsa e rritë fitimin bruto, duke bërë që malli të paguan më shumë tatim në fitim dhe meqë këto detyrime doganore paguhen menjëherë me rastin e importit atëherë nga rrjedha e parasë së gatshme (nga cash flow-i) do t'i angazhon ato mjete, pra do t'i heqë nga qarkullimi një pjesë të të ardhurave operuese.

<sup>52</sup>Dogana e Kosovës, Asycuda World, 2019

<sup>53</sup>Dogana e Kosovës, Raporti Vjetor 2018

## 7. Rezultatet nga mbledhja e të dhënave primare

Të dhënat primare janë mbledhur drejtpërdrejtë nga njësitë kërkimore dhe kanë përfshirë kategori të ndryshme respondentësh si importues malli, kontabilistë e zyrtarë doganor, inspektorë tatimor e shpediterë, moshash dhe profesionesh të ndryshme nga vende të ndryshme të Kosovës. Kemi përzgjedhur mostrën e rastësishme prej 30 individësh si në tabelë:

Njësia kërkimore	Frekuenca	Përqindja
Importues	9	30%
Kontabilist	9	30%
Zyrtar doganor	4	13%
Inspektor tatimor	5	17%
Shpediter	3	10%
Gjithsejtë	30	100%

Hulumtimi përpiket të hedhë dritë mbi problemin kërkimor të vlerës transaksionale si reflektim i vlerës reale dhe ndikimit të shtesës nga vlerësimi doganor në koston e mallit të importuar. Derisa kemi marrë përgjegjet sipas tabelës në vazhdim:


Përshkrimi i pyetjes	Nr.i pyetjes.	Përgjegjet		Nuk e di	%
		Po	Jo		
Dogana vlerëson drejtë mallin?	12	21 apo 70%	4 apo 13%	5 apo 17%	100%
Shtesa efekturon koston reale?	21	11 apo 37%	-	-	100%
Shtesa rritë fitimin bruto?	21	10 apo 33%	-	-	
Shtesa efekturon balancën kreditore?	21	3 apo 10%	-	-	
Shtesa shtrenjton mallin?	21	6 apo 20%	-	-	
Vlera transaksionale përfaqëson koston reale?	23	30 apo 100%	-	-	100%

Tabela nr.7.1 Përgjegjet e respondentëve

Kemi ngritur hipotezën kryesore se: Vlera transaksionale e mallit të importuar synon të konstatojë koston reale të tij në funksion të doganimit objektiv për realizimin e objektivave fiskale të shtetit të Kosovës. Nga të dhënat primare si në tabelën nr. 7.1 prej 30 respondentëve të anketuar, 30 nga ata ndajnë mendimin se vlera transaksionale përfaqëson koston reale të mallit, duke marrë përgjegen pohuese prej 100% të tyre.

Të anketuarit, gjatë punës së tyre kanë zhdoganuar mallin sipas vlerës transaksionale në mbi 90% të rasteve, duke shoqëruar mallin me dokumentet e nevojshme për provim vlere të transaksionit dhe vlerësimi nga dogana sipas kësaj metode.

Rreth mënyrës së drejtë të vlerësimit nga dogana, respondentët kanë dhënë përgjegje pohuese (pozitive) 70%, prej tyre 13% kanë dhënë përgjegje mohuese (negative) ndërsa 17% nuk kanë ditur lidhur me vlerësimin doganor, sipas grafikut në vazhdim:




Grafiku nr. 7.2 Përgjegjet e respondentëve lidhur me vlerësimin doganor

Nga të dhënat sekondare të mbledhura nga dogana, rrjedh se metoda e vlerës së transaksionit për periudhën 2010-2018 të zhdoganimit të importit të rregullt, sipas mesatares së thjeshtë aritmetike është përdorur 91.58%. Nga vlera e përgjithshme e mallit prej 23.275.849.583,80€, është zhdoganuar mall me vlerë prej 96.91% sipas vlerës transaksionale të tij. Sipas raporteve vjetore dhe të dhënave sekondare nga dogana, aplikimi i vlerës transaksionale ka tendencë të rritjes në përputhje me rekomandimet e OBT-së. E konsiderojmë se, të dhënat primare nga respondentët dhe të dhënat sekondare nga importet e rregullta të mallit e mbështesin hipotezën se vlera transaksionale konstaton koston reale të mallit në funksion të doganimit objektiv për realizimin e objektivave fiskale të shtetit të Kosovës.

Hulumtimi ka të bëjë me situatën kur shtesa doganore është pranuar nga administrata tatimore, në koston e mallit dhe situatën kur ajo nuk pranohet. Disa të anketuar, fillimisht kanë konsideruar se shtesa doganore ka efektin vetëm në shumën e taksës doganore që inkasohet, pa analizuar efektin e rritjes së fitimit bruto, nga mospranimi si zë (element) i KMSH-së.

Kemi marrë për analizë, vetëm përgjegjet nga pyetjet që prekin vlerësimin e mallrave dhe koston shtesë nga vlerësimi.

Në pyetjen lidhur me efektin e shtesës doganore, të anketuarit janë përgjegjur si mëposhtë:



Grafiku nr.7.3 Përgjegjet e respondentëve lidhur me shtesën nga vlerësimi

Nga të anketuarit, 11 prej tyre apo 37% ndajnë mendimin se shtesa efektuon koston reale të mallit, ndërsa 10 prej tyre apo 33%, e rritë fitimin bruto të mallit dhe 6 prej tyre apo 20% se e shtrenjton mallin. Të tri këto elemente si rritja e koston, rritja e fitimit bruto dhe rritja e çmimit të mallit i rrisin detyrimet doganore në kufi dhe detyrimet tatimore në brendi të vendit për mallin ndërsa zvogëlojnë potencialin konkurues të mallit të importuar dhe potencialin financiar të importuesit.

Kjo do të rrisë fitimin kontabël ndyshe nga fitimi real. Nën këtë prizëm e konsiderojmë të qëndrueshme hipotezën ndihmëse: Aplikimi i metodave të tjera të vlerësimit dhe efektet e shtesës së vlerësimit në koston e mallrave të operatorëve ekonomik.

Sipas të dhënave primare të mbledhura nga respondentët lidhur me shtesën doganore, gjatë punimit kemi marrë për analizë situatat e mundshme që paraqiten me rastin e aplikimit të shtesës doganore para vendimit të administratës tatimore kur është pranuar shtesa në koston e mallit të shitur dhe pas vendimit të saj kur në koston e mallit të shitur nuk pranohet kjo shtesë.

Megjithatë, dallimi mes këtyre aplikimeve është shumë domethënës sepse derisa është pranuar shtesa doganore në koston e mallit të shitur, mallit që është vlerësuar me shtesë ka paguar vetëm 10% më shumë taksë doganore se malli që është pranuar sipas vlerës transaksionale. Ndërsa pas mos pranimit të shtesës në koston e mallit të shitur, malli që është vlerësuar me shtesë, paguan 10% më shumë taksë doganore në shtesë dhe 10% më shumë në tatimin në fitim.

Në këtë kuptim, konstatojmë në përputhje me hipotezën e dytë ndihmëse se domosdoshmëria e vlerësimit të disa mallrave sipas metodës së gjashtë, efektuon koston e mallit të importuar. Sipas kësaj, malli veçanërisht do të afektohet me rritjen e detyrimit doganor për 10% të shtesës, 10% tatimit në fitim nga kjo shtesë, komplikimeve rreth refundimit të TVSH-së së arkëtuar dhe të zbritshme, heqjes së mjeteve operuesesë nga qarkullimi për këto diferenca detyrimesh për pagesë.

Kjo është provuar me shembuj konkrte nga të dhënat primare të respondentëve. Dogana, në rastet kur nuk provohet vlera transaksionale e mallit dhe nuk mund të zbatohen metodat tjera të vlerësimit, e shtyrë nga arsyet e dispozitave ligjore dhe në përputhje me Nenin 7 të OBT-së, aplikon metodën e gjashtë të vlerësimit. Pra derisa shtesa doganore e rritë vlerën doganore të mallit ndërsa në anën tjetër shtesa nuk pranohet nga administrata tatimore si kosto reale e mallit të shitur rrjedhimisht këtë kosto do t'a bartë malli i importuar përderisa nuk provohet vlera transaksionale e tij.

## **8. Efekti i vlerësimit të mallit në të hyrat doganore**

Duke krahasuar me dekadën e parë të operimit të saj, dogana në periudhën e viteve 2010 deri 2018, ka vazhduar me trendin rritës të mbledhjes së të hyrave për buxhetin e shtetit. Në dekadën e dytë, falë kompletimit të rregullativës ligjore, përkushtimit dhe avancimit me metodat sipas sistemit operativ Asycuda, me sukses ka luajtur rolin mbrojtës dhe fiskal si qëllime strategjike të saj.

Politikat e duhura ekonomike, efektuojnë rritjen ekonomike, e cila e rritë kërkesën për furnizim me mallra. Kjo rritje kërkesë, nxitë rritjen e prodhimit të brendshëm dhe rritjen e kërkesës për mall nga importi (kur prodhimi i brendshëm nuk i plotëson kërkesat sasiore dhe kualitative). Rritja e importit, shprehet me rritjen e të hyrave për buxhetin e shtetit.

Ndërsa shuma e të hyrave, do të varet nga shumë faktorë si më poshtë:

- rrjedhat e çmimeve ndërkombëtare, rrjedhat ekonomike dhe politike ndërkombëtare, investimet e huaja, rregullativa ligjore, lirimet e mallit, ndalimet, lejimet, heqja e kufizimeve, struktura e mallit, marrëveshjet preferenciale, pakot fiskale etj.

Përkundër këtyre turbulencave, për këtë periudhë dogana ka përmbushur misionin e saj. Përgjatë këtyre viteve, ka zhdoganuar mall nga importi i rregullt me bazë doganore prej 23.275.849.583,80€. Marrë parasysh rrethanat e lartshënuara, nga kjo bazë doganore malli ka arritur të inkasojë të hyra të gjithmbarshme prej 8.126.643,292€ për buxhetin e Kosovës. Nga baza e përgjithshme doganore, 3.09% apo vlera prej 719.058.407,€ është shtesë nga vlerësimet sipas metodave të ndryshme nga metoda transaksionale, diferencë vlere nga vlera faturale, nga e cila janë inkasuar 205.780.696 € apo 2.53% të të hyrave të gjithmbarshme.

Viti	Y	X	Y <sup>2</sup>	X <sup>2</sup>	XY
	Të hyrat	Baza doganore			
2010	690.805	2063.159	477211.548	4256625.059	1425240.553
2011	813.995	2332.916	662587.86	5442497.063	1898981.959
2012	818.032	2366.061	669176.353	5598244.656	1935513.612
2013	812.954	2372.317	660894.2061	5627887.948	1928584.594
2014	845.49	2477.379	714853.3401	6137406.71	2094599.171
2015	925.9	2572.244	857290.81	6616439.196	2381640.72
2016	1025.686	2760.141	1052031.771	7618378.34	2831037.982
2017	1091.747	3005.945	1191911.512	9035705.343	3281731.436
2018	1102.028	3325.682	1214465.713	11060160.77	3664994.683
<b>Shuma totale</b>	<b>Σ 8126.64</b>	<b>Σ 23275.84</b>	<b>Σ 7500423.11</b>	<b>Σ 61393345.08</b>	<b>Σ 21442324.71</b>
<b>Mesatarja</b>	<b>ȳ 902.96</b>	<b>x̄ 2586.2</b>			

Tabela nr.8.1 Tabela e regresionit për periudhën 2010-2018

Nëse i bëjmë një analizë regresioni ndërmjet të hyrave dhe bazës doganore, rrjedhimisht rritja e bazës doganore në masë të caktuar efektuon rritjen e të hyrave, pra baza doganore është ndryshore e pavarur (x) ndërsa të hyrat ndryshore e varur (Y). Kjo marrëdhënie matematikisht shprehet me funksionin:  $Y=f(x)$ , ku Y- variabla e varur, është mesatarja e pritur e të hyrave për vlerën e dhënë të bazës doganore (x). Regresioni ka formën ekonometrike  $Y=a+bx$ , ku a-koeficienti kur baza doganore=0, pra kur nuk kemi shtesë doganore dhe b-koeficienti që tregon raportin mes Y dhe X.

$a=\bar{Y}-b\bar{X}$ , atëherë<sup>54</sup>, ku n-numri i viteve të analizuar.

$$b = \frac{\sum XY - n\bar{x}\bar{y}}{\sum X^2 - n\bar{x}^2}$$

$$r = \frac{\sum XY}{\sqrt{\sum X^2 * \sum Y^2}} = 0.999, \text{ ku r-koeficienti i korrelacionit}^{55}$$

Duke zëvendësuar vlerat nga tabela e regresionit, fitojmë:  $Y=a+bx$ ,  $b=0.355$

$\bar{Y}=a+b\bar{x}$ , atëherë  $a=\bar{Y}-b\bar{x}$  duke zëvendësuar kemi  $a=-15.141$ .


Fitojmë modelin ekonometrik:  $Y=-15.141+0.355x$ , sipas së cilit janë mbledhur të hyrat.

<sup>54</sup> B.Fetai, Ligjërata UEJL, Tetovë 2011

<sup>55</sup> R.Livoreka: "Kërkim marketing", Prishtinë 2011

Pra, nëse nuk do të rritej fare baza doganore atëherë të hyrat mesatarisht do të pësonin rënie prej 15.141 njësi, ndërsa nëse baza doganore rritet për 1 njësi atëherë të hyrat do të rriteshin mesatarisht me 0.355 njësi.

Trendi i shtesës nga vlerësimet, shikuar nga viti 2010 prej 99.475.021€ e deri në vitin 2018 prej 74.021.451€ është në rënie, në pajtim me parimet e OBT-së.



Grafiku nr.9.2 Të hyrat nga shtesat në raport me të hyrat e përgjithshme të importit të rregullt për 2010-2018

Sipas grafikut, kemi paraqitjen e të hyrave nga shtesa doganore në raport me të hyrat totale për periudhë. Nga të hyrat nga shtesat prej 205.780.696€, pjesa më e madhe është realizuar sipas metodës së gjashtë të vlerësimit në masën 91.83% apo 188.978.564,80€. Kjo është kosto doganore për operatorët ekonomik, e cila domosdoshmërisht e rritë koston e mallrave të importuara.

Aplikimi i metodës së gjashtë të vlerësimit, në përputhje me kodin dhe nenin 7 të OBT-së në pjesën më të madhe është zbatuar me rastin e vlerësimit të mallrave që nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm për të provuar vlerën e tij, mallit të përdorur për konsum jo ushqimor, automjetet e makineritë e përdorura, mallrat nga zonat gjeografike me rrezikshmëri të lartë, pemët e perimet, mallrat nga bursa ndërkombëtare etj.

Dogana do të vazhdon të aplikon metodën e gjashtë të vlerësimit të mallit, përderisa malli nuk mund të vlerësohet sipas metodave nga MV1 deri në MV5. Rezultatet e vlerësimit doganor, në vazhdimësi i kanë mbështetur edhe institucione ndërkombëtare nga “Komisioni Evropian”<sup>56</sup>.

## 9. Kontrolli pas Importues i operatorëve ekonomik

Me pagesën e detyrimeve doganore, malli lirohet në qarkullim të lirë. Ai merr atributin e mallit vendor, por origjina nuk i ndërron (derisa nuk e kalon procesin e caktuar të përpunimit, në përputhje me rregullat e origjinës). Mirëpo, me përfundimin e zhdoganimit, nuk do të thotë se malli nga importi s’do t’i nënshtrohet verifikimit të mëvonshëm nga Sektori i Inspektimit pas Zhdoganimit dhe Sektori i Kontrollës pas Importuese.

<sup>56</sup>Dogana e Kosovës, Raportet Vjetore 2010-2018

Sektori i Inspektimit pas Zhdoganimit, bën kontrolle dokumentare lidhur me përmbushjen e rregullativës ligjore të mallit importi i të cilit nuk ka kaluar afatin pesë ditësh. Bën përzgjedhjen e lëndëve për kontrollë sipas profileve të riskut. Nëse konsiderohet se ka nevojë për rivlerësim malli, sektori do të korigjojë dudat dhe do t'i inkasojë të hyrat shtesë pasi që importuesi apo deklaruesi (shpedicioni) të njoftohen me lëshimin e pagesës shtesë.

Të dy këta sektorë, bëjnë verifikimin e vlerës doganore, në pajtim me parimet e OBT-së. Bëhet përqëndrim më i madh i doganës në kontrolla pas zhdoganimit përmes verifikimit të vlerave të deklaruara. Në këtë rast, kur kemi inkasim të të hyrave shtesë për diferencë vlerë në mallin e zhoguanuar, kemi të bëjmë më rivlerësim malli.

Pra këtu qëndron dallimi mes vlerësimit dhe rivlerësimit të mallit. "Sektori i Kontrollës pas Importi, sipas planit, realizon kontrolla të paralajmëruara dhe të pa paralajmëruara të operatorëve të ndryshëm"<sup>57</sup>. Përpos vlerësimit të mallit, kontrollon operatorët në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me legjislacionin doganor. Kontrollon të gjitha procedurat doganore dhe të gjitha regjimet doganore, me kompetenca të gjera për kontrollë retroaktive deri në tri vite, e me autorizim të posaçëm deri në pesë vite. Kontrolli nuk kufizohet vetëm në aspektin dokumentar.

Ai bëhet edhe në objektet e operatorit, prodhuesit, personave fizik dhe çdo hapsire tjetër, pra bëhet kontrolli fizik i mallit, numërimi i tij, i stoqeve, krahasimi me librat tregtar, marrja e mostrave, librave kontabil, kontrollimi i transaksioneve bankare etj.

Kontrolli pas importues, kujdeset për përmbushjen e dispozitave në fuqi. Kontrolla përfundon me përpilimin e raportit të kontrollës apo me aktvendim për inkasim të të hyrave shtesë. Varësisht nga evazoni doganor eventual, inicohet procedura administrative kundërvajtëse apo ajo penale.

Shembull nga praktika doganore në Kosovë:

"Prodhuesi K, importon komponentin A dhe B (lëndë e parë), për prodhim të produktit C. Komponentët A dhe B, marrin pjesë me nga 50% në përberjen e produktit C. Malli është nga bursa ndërkombëtare, ndërsa importohet me taksë të pezulluara sipas procedurës respektive. Pas prodhimit, ai e shet produktin C, nën çmimin e dy komponenteve A dhe B së bashku dhe shpenzimeve të prodhimit. Tani, kontrolla pas importuese duke i realizuar një inspektim dokumentar, vëren një dud me parregullësi në bazën doganore.

E vërteton se bëhet fjalë për nënvlerësim malli ndërsa e realizon një vizitë kontrolli në ambientet e fabrikës. I regjistron stoqet e mallit, merr regjistrat tregtar, dokumente të tjera dhe fillon me kontrollë të përgjithshme retroaktivisht. Prodhuesi K e ka shitur produktin C, më lirë se vlera e të dy komponenteve përbërëse të tij, me arsyetimin se çmimi i produktit të gatshëm C, ka pësuar rënie në bursën ndërkombëtare. Kjo nuk qëndron sepse kur janë importuar komponentet A dhe B, u janë pezulluar taksat sipas autorizimit për procedurë (ato janë borxh për importuesin). Pas një periudhe kohe, kontrolla përfundoi me aktvendim për inkasimin e një shume të lartë të të hyrave shtesë, për evazionin doganor. Taksat sipas aktvendimit janë inkasuar ndërsa ndaj importuesit është inicuar procedura penale. Nga zyrtari i kontrollës, lënda është dashur të arsyetohet dhe të mbrohet para organeve të ndjekjes"<sup>58</sup>.

<sup>57</sup>Dogana e Kosovës, SKPI PSO

<sup>58</sup>Dogana e Kosovës, SKPI Aktvendim nr.05.1/115 dt.26.02.2015

## 10. Përfundim

Punimi argumenton se aplikimi i metodës së parë të vlerësimit, reflekton koston reale të mallit. Gjatë vlerësimit, malli sipas metodës transaksionale është i shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm për argumentimin e vlerës sipas faturës .

Kjo do t'i kursejë importuesit kohën ndërsa nuk do të ketë kosto shtesë. Kjo metode e vlerësimit do të vazhdojë të aplikohet derisa importuesit të deklarojnë çmimin real të mallit të importuar ose të pagueshëm të mallit për import në Kosovë.

Domosdoshmëria e aplikimit të metodave alternative të vlerësimit, e veçmas metodës së gjashtë MV6 efektua rritjen e koston të importit në pajtim me pikën dy të hipotezës ndihmëse të këtij punimi, e argumentuar nëpërmjet shembujve të prezenetuar në punim nga anekta me responentët.

Aplikimi i metodës MV6, duke i llogaritur shtesën vlerës të mallit, njëkohësisht e rritë fitimin bruto ndërsa rritet baza për tatimin në fitim. Natyrisht, kjo nuk është intencë e doganës, mirëpo është e domosdoshme që për mallrat të cilët nuk mund t'a dokumentojnë apo t'a provojnë çmimin e tyre të deklaruar, si kosto do të marrin shtesën derisa nuk tregtojnë sipas praktikave dhe rrjedhave tregtare e doganore.

Nga vlerësimi doganor sipas metodave alternative MV2 deri MV6, për periudhën 2010-2018, janë mbledhur 205.780.696,02€ nga shtesa doganore e përgjithshme prej 719.058.407,31€ gjithnjë duke pasur parasysh faktorët që nxisin dhe faktorët që frenojnë rrjedhat e importit të mallit.

## 11. Rekomandim

Mbi bazën e analizës së punimit, punës praktike si vlerësues i mallit doganor dhe duke marrë në konsideratë trajtimet e problematikës me anketuesit për shtesën doganore si kosto e mallit të vlerësuar, me qëllim të krijimit të lehtësirave për vlerësim malli, i kondiderojmë rekomandimet :

- Dogana e Kosovës të vazhdojë të aplikojë metodën transaksionale në të gjitha rastet e mundshme derisa ekzistojnë kushtet për aplikimin e saj, pa cenuar dispozitat ligjore
- Me rastin e vlerësimit të mallit sipas metodës transaksionale, të konsultohen të gjitha të dhënat lidhur me dërgesën e mallit dhe kërkesat eventuale të institucioneve publike dhe të sigurisë.
- Që sektorit të pranimit dhe vlerësimit të mallit, t'i paraprijnë me informacione nga inteligjenca dhe analiza e riskut,
- Që vlerësuesit e mallit të kërkojnë dokumentet e nevojshme dhe plotësuese për provimin e vlerës transaksionale të tij,
- Sektori i vlerësimit, pavarësisht dokumenteve të bashkangjitura, t'i analizojë indikatorët e ndryshëm për vlerësim sipas UA 67/2009 dhe praktikave doganore,
- Të konsultohet në vazhdimësi, historiat i importeve të operatorit dhe operatorëve të tjerë sipas mallit që vlerësohet,
- Që në rast dyshimi për klasifikim tarifor, dyshim origjine apo kualiteti, të konsultohet sektori i tarifës, sektori i origjinës apo laboratorit i doganës,



- Në rast të zbulimit të ndonjë parregullsie prej më herët, lënda të adresohet për kontrollë pas importi retroaktivisht ,
- Që nëse nuk është e mundur vlerësimi i mallit sipas metodës MV1, t'i aplikojë metodat tjera alternative të vlerësimit sipas renditjes kronologjike, në përputhje me dispozitat e kodit dhe ato të OBT-së,
- Nga analiza e riskut të profilizohen lëndë më pak në sektorin e pranimit dhe vlerësimit ndërsa të verifikohen përmes sektorit të kontrollës psa importuese retroaktivisht ,
- Që Sektori i Vlerës në vazhdimësi t'i freskojë me të dhëna modulet e të dhënave,
- Të parapaguhen për qasje, module on-line për vlerësim mallrash të përdorura,
- Të vazhdohet me vlerësimin e mallit të përdorur sipas MV6,
- Dogana të aplikojë shtesën e vlerësimit doganor, derisa operatorët nuk mund t'a provojnë vlerën transaksionale të mallit,
- Të vazhdohet me mospranimin e shtesës si kosto nga ATK-ja derisa operatorët të mos e dokumentojnë koston reale të mallit,
- Që shtesa të aplikohet vetëm mbi bazën e fakteve për të ulur ankesat eventuale,
- Të vazhdohet me aplikimin e shtesës së vlerësimit, për mbrojtjen e tregut vendor nga konkurrenca jo e drejtë,
- Të vazhdohet me shtesën nga vlerësimi, për të mbrojtur të hyrat e buxhetit të vendit,
- Që në emër të lirisë së lëvizjes së mallit të mos anashkalohej metodat jo transaksionale,
- Të vazhdohet me shtesa nga vlerësimi sepse ato kanë prodhuar efekte fiskale shtese,
- Që zyrtari i vlerësimit domosdoshmërisht të mbahet në trend me zhvillimet dhe praktikatat doganore të vendeve tjera,
- Të ndiqet praktika e profilizimit të zyrtarit për vlerësim të mallit të importuar,
- Të aplikohet sistemi i stimulimit të zyrtarëve të vlerësimit të mallit të importuar,
- Në vazhdimësi të plotësohen kërkesat për sisteme operative bashkohore për vlerësuesit,
- Që sistemet operative t'i përgjigjen kërkesave të tregtisë ndërkombëtare,
- Të thellohet bashkëpunimi me organet e zbatimit të ligjit në Kosovë, Njësinë e Inteligjencës Financiare, ATK, ministri të ndryshme etj,
- Që kontrolla pas importuese të përqendrohet në kontrollin e mallrave të importuara për projektet e mëdha nacionale, rreth verifikimit të vlerave faturale të mbivlerësuar,
- Të afirmohet bashkëpunimi mes doganës dhe asociacioneve të operatorëve ekonomik
- Të intensifikohet bashkëpunimi mes doganës dhe odave ekonomike,
- Që të krijohen module të reja për lehtësimin e tregtisë në mes Kosovës dhe vendeve tjera
- Të vazhdohet me bashkëpunimin mes administratave doganore rajonale e më gjerë rreth shkëmbimit të informacioneve,
- Të bëhen përpjekje për anëtarësimin e doganës nëpër nisma rajonale dhe mekanizma e organizata ndërkombëtare për qasje informatash e lehtësirash për tregtinë.
- Të freskohet legjislacioni doganor, në përputhje me të arriturat e zhvillimit .
- Të përcillen rekomandimet, komentimet e interpretimet nga OBT-ja.

## 12. Bibliografia

- Y.Raci: "Bazat e sistemit doganor", Prishtinë 2010 ,  
R.Osmani: "Kontabiliteti menaxherial për biznes" Tetovë, shtator 2011  
R.Osmani: Ligjerata, "Analiza e pasqyrave financiare" viti akademik 2018, UEJL-FAB  
H.S.Rosen: "Public finance" sixth edition, Tiranë 2003  
S.Berisha "Ekonomia ndërkombëtare", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2002 ,  
S.Kadriu "Financimi publikime vështrim të posaçëm në Kosovë" Sabriko, 2003 ,  
R.Livoreka: "Këkim marketingu:", Prishtinë 2011  
O.M. Qeku, "E drejta doganore", Kolegji Pjetër Budi, Prishtinë 2014 ,  
B.Jelçiç "Shkenca mbi financat dhe e drejta financiare", ETMK , Prishtinë 1985  
J.Biljakovska "Sistemi doganor", Botues Universiteti "Pjetër Budi", Prishtinë 2006  
BERR Claude - Jean, "Hyrje në të drejtën doganore", Editori Economica, Paris 2008  
J.Janao "Historia e doganave" – 2002  
BERR Claude - Jean, TREMEAU Henri, "E drejta doganore komunitare dhe kombëtare", Edicioni i 7, Editori Economica, Paris – 2006 ,  
Kodi Nr.3/L-109 : Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës  
Rregullorja e UNMIKUT Nr. 1999/1 ,(25 Qershor 1999)  
Rregullorja e UNMIKUT Nr. 1999/3 ,(31 Gusht 1999)  
Dogana e Kosovës, Plani strategjik (2016-2018)  
Ligji Nr.8449, datë 27.01.2004, Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë  
Udhëzimi Administrativ 11/2009, Për Implementimin e Kodit të Doganave dhe Akcizës  
Asycuda, Manuali i përdorimit, Prishtinë, Shkurt 2012
- Tarifa e Integruar e Kosovës, 2019 ,  
Dogana e Kosovës <https://dogana.rks-gov.net/>  
Dogana e Shqipërisë <http://www.dogana.gov.al/> ,  
Dogana e Maqedonisë Veriore <http://www.customs.gov.mk>  
Administrata Tatimore e Kosovës <http://www.atk-ks.org>  
Dogana e Kroacisë <https://carina.gov.hr>  
Oda Ndërkombëtare e Tregtisë <https://iccwbo.org/>  
World Trade Organization (OBT) <https://www.wto.org/>  
Agjencia e Statistikave të Kosovës <http://ask.rks-gov.net/>  
Fjalor i gjuhës shqipe <http://www.fjalori.shkenca.org/>

Nënshkrimi i kandidatit

---

**Faton Krivanjeva**

Nënshkrimi i mentorit

---

**Prof. Dr. Rufi Osmani**